



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor
“Matematikë”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti “Ismail
Qemali, ”, Vlorë”**


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Fatmir HOXHA
2. Prof. As. Eglantina KALLUÇI

Shtator/2021

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bsc në “Matematikë” ofruar nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë


Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Matematikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Matematikë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 832, datë 04.06.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 439, datë 09.09.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12PAE / OPAK v.a. 2019-2020 10PAE / OPAK v.a. 2018-2019 18PAE / OPAK v.a. 2017-2018
18	Numri i studentëve:	10 Studentë v.a 2019-2020 2 Studentë v.a 2018-2019 13 Studentë v.a 2017-2018
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës


Komisioni shqyrtoi dokumentacionin e ngarkuar në faqen www.ascal.al (lista e dokumentacionit) për programin e studimit Bachelor Matematikë. Në datë 22.02.2021 u krye vizita dy ditore (online) në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë për t’u njohur me stafin e Departamentit të Matematikës si dhe strukturat përgjegjëse pranë Fakultetit të Shkencave Teknike. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë e ushtron aktivitetin e tij mësimor-kërkimor bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij dhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit. Programi i studimit Bachelor në “Matematikë” i ciklit të parë ofrohet nga Departamenti i Matematikës dhe është pjesë e njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Teknike, të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë. Departamenti i Matematikës është hapur në vitin akademik 2008-2009, me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.832, datë 04.06.2008. Në vitin 2011 është diplomuar brezi i parë i studentëve. Deri më tani Departamenti i Matematikës ka diplomuar 11 (njëmbëdhjetë) breza studentësh (deri në vitin akademik 2019-2020). Programi i studimit Bachelor në “Matematikë” ofron përgatitjen, formimin dhe diplomimin e studentëve në fushën e matematikës dhe programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë. Ky program ofrohet me kohë të plotë dhe është organizuar duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit (VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018). Programi Bachelor në “Matematikë” i përket nivelit 6 (gjashtë) (bachelor) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi është organizuar në 6 (gjashtë) semestra akademike me nga 30 kredite (ECTS) secila. Programi Bachelor në “Matematikë” zhvillohet me kohë të plotë në 3 (tre) vite akademike në gjuhën shqipe. Lëndët e programit janë të ndara në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, dhe lëndë ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse sipas Udhëzimit të MASR Nr.41, dt. 24. 01. 2018. Aktualisht, Departamenti i Matematikës ka në përbërjen e tij staf akademik prej 15 (shtatë) pedagogësh me kohë të plotë, nga të cilët, 2(dy) Profesor i Asociuar, 7 (shtatë) Doktor i Shkencave dhe 6 (gjashtë) Master i Shkencave.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Përbërja e GVJ: Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën **Prof. Dr. Fatmir Hoxha** dhe **Prof. As. Dr. Eglantina Kalluçi** si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL **Z. Muhamed Prezja**.


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin e jashtëm për herë të parë të Programit të Studimit Bachelor në "Mateamtikë" ofruar nga Departamenti Matematikës, Fakulteti i Shkencave Teknike (FSHT), Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV). Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën Departamenti i Matematikës (FSHT/UV) është i përgatitur dhe i angazhuar për të përmbushur standardet akademike të diplomave që lëshon. Për të arritur në këtë gjykim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin bazohet veprimtaria e IAL (statuti, rregullorja, strategjia etj.), dosjen e programit të studimit, dokumentacionin e sekretarisë mësimore, takimet dhe vizitat "on-line" e organizuara në institucion, e cila konsistoi në njohjen me të gjitha strukturat përbërëse të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë (UV), Fakultetit të Shkencave Teknike dhe veçanërisht me Departamentin e Matematikës, Përgjegjësen e Departamentit Prof. As. Ll. Sota, stafin e Departamentit të Matematikës, me të cilët u diskutuan dhe u sqaruan çështje që GVJ i kishte përgatitur pas njohjes me dokumentacionin e dorëzuar dhe RVB. Pas vizitës në institucion, GVJ krijoi ide të qarta rreth funksionimit të strukturave të IAL-së që ofrojnë programin e studimit Bachelor Matematikë, hartimin e këtij programi studimi dhe këto përfundimi i parashtrori në formën e një raporti si më poshtë vijon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Matematikë”



I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti i Vlorës, Fakulteti i Shkencave Teknike, Departamenti i Matematikës ofron programin e studimit Bachelor Matematikë në përputhje me interesat kombëtare dhe konform kuadrit ligjor të përcaktuar në Ligjit Nr 80/2015, Neni 1, pika d, Neni 5/ 2ç. të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë. Ky fakt është pasqyruar në aktet rregullatore të IAL siç është Statuti apo Plani strategjik i zhvillimit. Evidenca Statuti i UV (2019) Neni 3, pika 2b, fq 7 Plani Strategjik 2018-2024 UV, fq 22, 24 Krijimi i DM KM Nr.832, datë 04.06.2008
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi është koherent me misionin e IAL të përcaktuar në Statutin e UV. Plani mësimor është bashkohor dhe shterues, programet e lëndëve janë të plota e të përditësuara dhe synojnë ruajtjen dhe kultivimin e vlerave kulturore kombëtare. Ky program studimi kërkon të pasurojë tregun me mësues cilësorë të matematikës, i cili ka shërbyer ndër vite si burimi kryesor për rajonin e jugut. Evidenca Statuti i UV (2019) Neni 3, pika 2b, fq 7.
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor Matematikë ofrohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e UV-së dhe FSHT. Ai ka si qëllim formimin e specialistëve të lartë në fushën e matematikës, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, punën kërkimore-shkencore në matematikën teorike dhe atë të aplikuar. Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës (kryesisht me formimin e mësuesve të ardhshëm) dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë, madje i mundëson studentëve të vijnë studimet e cikleve më të larta në IAL brenda dhe jashtë vendit. Evidenca Plani strategjik UV 2018-2024 fq. 22, 24 Rregullore e FSHT-së, Neni 2, fq. 3 Plani strategjik i Departamentit të Matematikës.
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit Bachelor Matematikë është hartuar në përputhje me nevojat dhe rajonale për të përgatitur mësues matematike për arsimin publik dhe atë privat të rajonit. Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor Matematikë përgatiten me njohuritë bazë të matematikës teorike dhe asaj të aplikuar duke i bërë të ndihen kompetentë në kryerjen e analizave dhe përpunimeve matematikore në fushën e ekonomisë, çështjeve sociale e më gjerë. Njohuritë e përvetësuara në tre vite





	<p>akademike, janë planifikuar për tu dhënë mundësinë për të vijuar studimet e mëtejshme në të njëjtën disiplinë apo në drejtimet e teknologjisë së informacionit apo ekonomisë, megjithatë destinacioni i pjesës më të madhe të studentëve të diplomuar në këtë program është profesioni i mësuesisë.</p> <p>Evidenca Statuti i UV (2019), Nenit 3, pika 2, shkr.b, fq.7 Plani strategjik i Departamentit të Matematikës, pika 1, fq. 5-6 Kurrikula Bachelor DM 2017-2020</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Referuar Planit Strategjik që UV ka hartuar për periudhën 2018-2024 rezulton se programi i studimit Bachelor në Matematikë është në përputhje me objektivat dhe në zbatim të këtij plani strategjik, sipas të cilit motivohen dhe nxiten studentët për të përvetësuar dhe për përcjelljen e informacionit në funksion të zhvillimit të shoqërisë dhe mjedisit.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Bazuar në Statutin e UV-së (publikuar “online” në: https://univlova.edu.al/statuti/) dhe Rregulloren e këtij universiteti (publikuar “online” në: https://univlova.edu.al/rregullorja/) janë përcaktuar qartë drejtimet prioritare akademike të programit Bachelor Matematikë dhe më konkretisht konsistojnë në i cili në rritje të standardeve të cilësisë, përmirësimin e programit të studimit, forcimin e orientimit të studentëve drejt tregut të punës, zgjerimin e edukimit drejt specializimeve të gjera dhe zhvillimi i formave të reja të edukimit, sigurimin e infrastrukturës së mësimi dhe asaj organizative. Evidenca: https://univlova.edu.al/statuti/ https://univlova.edu.al/rregullorja/
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të institucionit.	Referuar kriterit të mësipërm si dhe takimit me autoritet drejtuese të universitetit dhe në veçanti të Departamentit të Matematikës rezulton se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushat e drejtimeve akademike të institucionit, fakultetit dhe departamenteve brenda tij, strategjinë për zhvillim të UV dhe udhëzimeve të MASR. Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në ka për qëllim edukimin e brezave për të qenë mësues dhe specialistë të sektorit privat dhe publik. Evidenca Plani strategjik i Departamentit të Matematikës. Kurrikula Bachelor DM 2017-2020


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Referuar Planit Strategjik të UV, 2018-2024 dhe në veçanti Plani strategjik të Departamentit të Matematikës, GVJ evidentoi se ai është hartuar me qëllim formimin dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e drejtimit të mësimdhënies.</p> <p>Objektivat e çdo lënde të programit të studimit së bashku me njohuritë dhe kompetencat që fitojnë studentët prej tyre janë paraqitur në syllabuset përkatës. Ky program synon t'i pajisë studentët me njohuri të përgjithshme (lëndët bazë) dhe specifike/profesionale, duke i aftësuar ata për kualifikime të mëtejshme (Master Profesional/Shkencor).</p> <p>Referenca: Planit Strategjik të UV, 2018-2024. Plani mësimor i programit Bachelor Matematikë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe nga takimi me studentët si dhe stafin akademik të Departamentit të Matematikës, GVJ arriti në konkluzionin se programi i studimit Bachelor Matematikë është hartuar bazuar në eksperiencat e universiteteve vendase dhe të huaja, por nuk ekziston një studim tregu i mirëfilltë për këtë program, por stafi akademik i mbështet studentët për tu punësuar në fushën e mësimdhënies në sektorin privat dhe atë publik.</p> <p>Nga të dhënat e vëna në dispozicion dhe takimi me stafin akademik rezultojnë se studentët që ndjekin studimet kryesisht janë nga Fieri, Vlora dhe më pas Lushnja dhe Berati.</p> <p><i>GVJ vëren se një mungon një studim i mirëfilltë i tregut të punës për programin e studimit Bachelor Matematikë dhe sugjeron që të kryhet një i tillë dhe gjykon se kjo mund të ndihmojë në rritjen e numrit të studentëve në këtë program studimi.</i></p> <p><i>Një tjetër sugjerim është referimi i drejtpërdrejtë me sektorin privat dhe publik arsimor, nisur nga gjeografia e afërt e universitetit me vendbanimin si dhe gjurmimi me anë të grupeve Alumni.</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar plan-programit të programit të studimit Bachelor Matematikë dhe syllabuseve të lëndëve rezultojnë se studentët e diplomuar në këtë program studimi mund të vijojnë studimet e mëtejshme në programet Master Profesional / Master i Shkencave në Matematikë dhe programe të ngjashme. Meqë mësuesia futet në profesionet e rregulluara, të diplomuarit në Bachelor Matematikë nuk mund të punësohen si mësues.</p>



7


Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Teknike si një prej fakulteteve të UV përbëhet nga 7 departamente dhe Departamenti i Matematikës është një prej tyre dhe konkretisht që ofron programin e studimit Bachelor në Matematikë prej 11 vitesh.</p> <p>Aktualisht Departamenti i Matematikës përbëhet prej 15 pedagogësh efektivë (PAE) nga të cilët 2 mbajnë titullin Prof. As., 7 titullin Dr. dhe 6 MSc. Përveç stafit akademik të Departamentit të Matematikës në programin e studimit Bachelor Matematikë aktivizohen edhe pedagogë nga departamente të tjera të FSHT për vitin akademik 2019-2020, si nga Departamenti i Fizikës dhe Informatikës, të cilët ishin prezent edhe në takimin e zhvilluar në UV.</p> <p><i>Bazuar në ngarkesën mësimore të departamentit rezulton se ngarkesa mbulohet nga pedagogë efektivë dhe ngarkesa e tyre plotësohet kryesisht me lëndët që ato ofrojnë për degë të tjera. Ambientet dhe baza laboratorike është e kënaqshme.</i></p> <p>Evidenca: Organika e Departamentit të Matematikës. https://uni.vlora.edu.al/en-organigrama/</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Evidencat vërtetojnë se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor Matematikë është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSHT-së dhe Departamentit të Matematikës në veçanti dhe është organizuar sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit bazuar në udhëzimeve kombëtare e evropiane si dhe në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Ky program i ofruar nga Departamenti i Matematikës është i nivelit 6 (gjashtë) dhe është në përputhje me të gjitha dizpozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi (Statuti i UV).</p> <p>Përsa i përket kodifikimit, programi i studimit Bachelor në "Matematikë" është ndërtuar në ngjashmëri me programet e ngjashme të universiteteve të tjera, konkretisht Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, në një masë afërsisht 75% për t'ju mundësuar studentëve transferimin e krediteve si dhe vijimin e studimeve të ciklit të dytë pranë këtij fakulteti ose anasjelltas.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e</p>	<p>Programi i studimit Bachelor Matematikë ofrohet nga Departamenti i Matematikës dhe përputhet plotësisht me fushën e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit.</p>

 8

<p>kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i Matematikës specifikisht mbështet formimin matematikor të këtyre specialiteteve në funksion të programeve përkatëse. Kjo gjë reflektohet në planet mësimore përkatëse. Kurrikula e programit Bachelor Matematikë është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; lëndët janë të kategorizuara aipas linjave të formimit bazë, të përgjithsme dhe specifike, me qëllimi formimin e studentëve për të vijuar studimet e ciklit të dytë në programet e ofruara nga UV ose universitete që ofrojnë programe të ngjashme brenda apo jashtë vendit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UV, Statutin e UV, GJV evidenton se ekzistojnë të gjitha strukturat brenda institucionit qofshin këto akademike, ndihmë-akademike dhe administrative referuar përcaktimeve në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe të reflektuatuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Vlorës.</p> <p>Universiteti i Vlorës është i përbërë nga katër fakultete dhe Departamenti i Matematikës është njësia bazë në përbërje të Fakultetit të Shkencave Teknike.</p> <p>Nga vizita e kryer me strukturat respektive administrative dhe akademike vihet re funksionimi i tyre konform përcaktimeve ligjore dhe me qëllim mbarëvajtjen e procesit mësimor, shkencor dhe administrativ.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/en-organigrama/</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Referuar publikimeve në faqen zyrtare https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/erasmus/ si dhe nga takimi që GJV realizoi me përfaqësues të Zyrës së Marrëdhënieve më Jashtë rezultoi se institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj. Aktualisht Universiteti i Vlorës ka marrëveshje aktive me dhjetëra universitete evropiane, ku dominojnë ato Italianë, kjo për efekt gjeostrategjik por nuk mungojnë edhe bashkëpunimet me universitetet në SHBA.</p> <p>Evidence për thirrjet e hapura si dhe projektet aktive është informacioni i publikuar në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/erasmus/</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të</p>	<p>Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri GJV vë re se ekzistojnë evidenca në Raportin Vjetor të Punës për periudhën Tetor 2018-Shtator 2019 të Departamentit të Matematikës si njësi bazë përgjegjëse për programin e</p>





përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	studimit Bachelor Matematikë, për raportet analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, të cilat konsistojnë në vlerësimin e mobiliteteve të stafit dhe pedagogëve dalës dhe hyrës, në komunikimin e eksperiencës së fituar tek anëtarët e tjerë të personelit akademik. <i>GVJ e konsideroi këtë kriter një pikë të fortë të njësisë pasi shkëmbimet kanë qenë të shpeshta në të dy kahet.</i>			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Nga vizita dhe takimi me strukturat përgjegjëse GVJ evidentoi se universiteti ka pak praktika për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës për një sërë programesh studimi, kryesisht në ciklin e dytë. <i>Në rastin e programi të studimit Bachelor Matematikë nuk ka evidencë për marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara, fakt që justifikohet pasi në planin mësimor të këtij programi nuk kryhet praktikë profesionale.</i>			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Matematikës konstatohet se UV ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët në bashkërendim me Qendrën e Zhvillimit Rajonal (RDC) Kjo qendër ofron trajnime profesionale të edukimit të vazhdueshëm për studentët dhe stafin. Një evidencë e formimit të vazhduar është projekti TEAVET ku kualifikohen mësuesit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, si dhe studentët të Departamentit të Matematikës, por të programit Master Profesional në Matematikë. Evidenca: https://trajnime.arsimi.gov.al/Trajnimes/TrajnimeTeavet			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjisllacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Referuar dokumentacionit shkresor të vënë në dispozicion GVJ arrin në përfundimin se programi i studimit Bachelor në Matematikë është i organizuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015, si dhe VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”.


 10

	<p>Bazuar në Planim mësimor të programit Bachelor Matematikë dhe në takimet “online” me përgjegjësen dhe stafin e departamentit u vu re se ky program studimi është i organizuar në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mësimor realizohet në 3 (tre) vite studimi (6-gjashtë, semestra), me një numër total kreditesh 180. Lëndët mësimore janë të klasifikuara sipas kategorive A, B, C, D, E, F, sipas këtyre përqindjeve:</p> <p>A. Lëndë bazë (30 kredite – 16.7%); B. Lëndë karakterizuese (93 kredite – 51.7%); C. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese (22 kredite – 12.2%); D. Lëndë Plotësuese (26 kredite – 14.4%); E. Detyrime Përmbyllëse (6 kredite – 3.3%).</p> <p>Kurrikula është e ndërtuar në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara nga kuadri ligjor si dhe programet e ngjashme brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë Rregullore e Programeve të studimit të Departamentit të Matematikës.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga Departamenti i Matematikës (Plani mësimor dhe syllbuset e lëndëve) GVJ vuri re se programi i studimit Bachelor Matematikë përmban lëndë bazë të matematikës që i ndihmojnë në formimin e mirë nëse do të ndjekin drejtimin e mësuesisë, si dhe në lëndë specifike për t’ju dhënë mundësinë e një baze të përshtatshme për ato që do të ndjekin rrugën e kërkimit shkencor.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë. Syllbuset e lëndëve të programit Bachelor Matematikë.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ vë re se programin e studimit Bachelor Matematikë, plani mësimor i tij, organizimi i lëndëve sipas tipologjive me mbi të gjitha tematika e pasqyruar në syllabuse është një evidencë që studentët e këtij programi marrin njohuri të përparura në fushën e matematikës. Lëndët janë të organizuara në leksione, seminare dhe orë laborator (për disiplinën e fizikës dhe informatikës) në një raport të drejtë dhe në përputhje me objektivat e programit. Literatura bazë dhe ajo ndihmëse është e përshtatshme dhe koherente me atë të programeve të njëjta në IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit. Evidencë për këto janë edhe shkëmbimet Erasmus+ të studentëve si dhe vijimi i studimeve master në universitetet të tjera.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë. Syllbuset e lëndëve të programit Bachelor Matematikë.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme</p>	<p>Referencë e përmbushjes së këtij kriteri nga GVJ janë syllbuset e përditësuara, softet që përdoren për konkretizimin dhe modelimin e metodave dhe përpunimeve statistikore. Programi përmban lëndë të karakterit bazë dhe atij karakterizues, ku këto të fundit mundësojnë një analizë komplekse të problemeve të ndryshme.</p>



në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë. Syllabuset e lëndëve të programit Bachelor Matematikë, specifikisht literatura e detyruar dhe e rekomanduar.</p>			
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	<p>Nga GVJ u konstatua se programi i studimit Bachelor Matematikë është i strukturuar konform të gjithë elementeve të përcaktuar nga Ligji i Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Plani mësimor është i përbërë nga 6 semestra të ndarë në 3 vite akademike, ku lëndët janë të ndara sipas tipit të veprimtarisë. Syllabuset i përmbajnë të gjithë elementet e kërkuara në VKM 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e progeamit Bachelor Matematikë. VKM 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”.</p>			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>Referuar VKM Nr. 41 datë 24.01.2018, pika 2, shtojca nr.1, programi i studimit Bachelor Matematikë është organizuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi përmban 24 lëndë (174 kredite ECTS), dhe përgatitjen e diplomës (tezë/provim formimi me 6 kredite) pra në total 180 kredite të shpërndara në tre vite akademike.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e progeamit Bachelor Matematikë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion programi i studimit Bachelor Matematikës është hapur në vitin akademik 2008-2009, me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.832, datë 04.06.2008. Plani mësimor i këtij programi i është nënshtruar vlerësimit periodik nga Senati Akademik i UV dhe ka marrë vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Në datë 21.09.2017 Bordi i Akreditimit të ASKAL i ka dhënë vlerësimin institucional me Vendimin Nr. 71.</p> <p>Njësia kryesore është FSHT, e cila përbëhet nga 7 njësi bazë dhe Departamenti i Matematikës është përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor Matematikë. Njësia bazë është e organizuar në 3 grupe mësimore-kërkimore, Algjebër dhe Gjeometri analitike, Analizë dhe</p>

	<p>Ekuacione diferenciale-Gjeometri dhe Probabilitet – Statistikë dhe Matematikë e Aplikuar.</p> <p>Evidenca: Statuti i Universitetit të Vlorës. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Teknike. Rregullore e programeve të studimit të Departamentit të Matematikës. Vendimi Nr. 71, datë 21.09.2017 i Bordit të Akreditimit të ASCAL.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Referuar Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës, Neni 6, GVJ vë re se ky është një kriter i përmbushur si nga njësia kryesore ashtu edhe nga ajo bazë. Koordinator i programit të studimit është përgjegjësi i njësisë bazë, momentalisht është Prof. As. Llambri Sota. Detyra dhe përgjegjësia e koordinatorit është të kontrollojë ecurinë e procesit mësimor të studentëve dhe ti përcjellë drejtuesit të njësisë kryesore nevojat e tyre. Nga komunikimi me Prof. As. Ll. Sota evidentohet se ekziston bashkëpunimi midis instancave të ndryshme dhe mbështetja e kërkesave dhe nevojave që vijnë nga njësia bazë, në funksion të mirëkoordinimit dhe mbështetjes.</p> <p>Evidenca: Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës, Neni 6. Vendimi: Emërimi i Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Bazuar në konstatimet e GVJ si dhe referencave të zyrës së Burimeve Njerëzore pranë Universitetit “Ismail Qemali”, rezulton se Fakulteti i Shkencave Teknike përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin e strukturës akademike (Nr 80/2015, Neni 25, pika 4). Fakulteti i Shkencave Teknike përbëhet nga 7 (shtatë) departamente. Departamenti i Matematikës është një prej njësive bazë dhe është i organizuar konform përcaktimit ligjor si nga ana sasiore ashtu edhe ajo e kualifikimit të stafit akademik.</p> <p>Evidenca: Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës. Statuti i Universitetit të Vlorës. Rregullore e Universitetit të Vlorës. Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr 80/2015, Neni 25, pika 4.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>GVJ referuar informacionit të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe organikës së publikuar në faqen e UV konstaton se Departamenti i Matematikës është i strukturuar sipas kërkesave ligjore dhe konkretisht përbëhet nga 15(pesëmbëdhjetë) anëtarë efektivë si personel akademik (PAE), të punësuar me kohë të plotë, nga të cilët 2 (dy) Profesorë të Asociuar, 7(shtatë) Doktorë dhe 6(gjashtë) Master Shkencor.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/en-organigrama/</p>






<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Referuar sa është shkruar në Kriterin 4, Departamenti i Matematikës ka staf akademik të kualifikuar dhe të aftë për të përmbushur detyrimet e programit të studimit Bachelor në Matematikë. Ai ka në përbërje staf akademik me kohë të plotë, të kualifikuar në disiplina sipas grupeve mësimore-kërkimore në të cilat është i ndarë departamenti.</p> <p>Për shkak të numri të vogël të studentëve në vitet e fundit akademike ngarkesa mbulohet në masën 90% nga staf akademik efektiv i Departamentit të Matematikës.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/stafi-akademik-departamenti-i-matematikes/</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni që ka shqyrtuar si dhe nga takimi i zhvilluar me përfaqësues të njësisë kryesore dhe ato të njësisë bazë arrin në përfundimin që ato disponojnë dokumentacionin e plotë për programin e studimit ku përfshihen: Rregullorja e programeve të studimit të Departamentit të Matematikës; Planet mësimore (2016-2019 dhe 2017-2020) të shoqëruar me Syllabuset e lëndëve përkatëse dhe suplementin e diplomës, të gjitha sa më lart referuar LAL Nr 80/2015, Neni 25, pika 4 dhe VKM VKM Nr. 41 datë 24.01.2018.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve. Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar Planit mësimor të programit Bachelor Matematikë dhe formës së suplementit të diplomës, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor Matematikë është i hartuar konform përcaktimeve të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”, të kategorizuara si më poshtë:</p> <p>A. Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (32 kredite – 17.8%).</p> <p>B. Lëndë të formimit karakterizues: përgatitje për disiplinën shkencore: (98 kredite – 54.4%).</p> <p>C. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese: Lëndë të formimit të ngjashëm ose/dhe integruese me lëndët karakterizuese si dhe lëndë formuese të zgjedhura nga studentët: (24 kredite – 13.3%).</p> <p>D. Lëndë Plotësuese: Lëndë formuese dhe aktivitete që lidhen me përfundimin e aftësive për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës si: për njohje të gjuhës së huaj, informatikës, praktikë: (26 kredite – 14.4%).</p>



14

	<p>E. Detyrime Përmblyëse: Teza e diplomës ose provimi i formimit: (6 kredite – 3.4%).</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve. Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë. Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Nga verifikimi GVJ vë re se plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Matematikë organizohet sipas lëndëve të grupuara dhe të renditura në semestra; numri i krediteve për çdo lëndë dhe raporti i orëve (leksione dhe seminare); detyrimet sipas lëndëve (seminare, ushtrime, punime kursi, detyra kursi, detyra kontrolli). Programi i plotë shtrihet në 3 vite akademike, ekuivalent me 6 semestra, dhe totali i krediteve të fituara nga studenti që ndjek këtë program studimi është 180 kredite. Viti akademik përbëhet nga 2 semestra, secili nga 15 javë dhe numri i krediteve të fitura në një vit akademik është 30 kredite.</p> <p>Referuar edhe formatit të Suplementit të diplomës Bachelor Matematikë vihet re organizimi i lëndëve e moduleve, të vlerësuara me kredite, si dhe shkallës ECTS të notave sipas sistemit të BE-së.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve. Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë. Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Bazuar në Planin mësimor, syllabuset e lëndëve si dhe diskutimin online me përfaqësuesit e Departamentit të Matematikës, GVJ arriti në përfundimin se plani mësimor përmban infomacion të plotë mbi kurrikulën e programit Bachelor Matematikë. Përcaktimi i krediteve për secilën lëndë është në proporcion me standartin 25 orë mësimore punë për kredit. Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas përcaktimeve ne VKM 41 datë 24.01.2018, dhe kanë të gjithë elementet që përcaktojnë ndarjen e ngarkesës për secilën lëndë në auditor dhe jashtë tij, si dhe mënyrën e vlerësimit (Provim ose Vlerësim i vazhdueshëm) dhe kontrollin e dijeve.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve. Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë. Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe informacioni në faqen zyrtare të UV-s, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet dhe se njësia kryesore dhe njësia bazë përdorin një mekanizëm transparent për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, Udhëzim i MASR, Nr.10, datë 15.05.2019 dhe udhëzimet e përvitshme për afatet</p>

	kohore dhe listën e dokumentacioneve (P.Sh. Udhëzim i MASR Nr.19, datë 10.09.2019, për vitin akademik 2019–2020).			
	<i>Mungon shpallja e kritereve për pranimet në ciklin e parë, pavarësisht vaktit se maturantët i referohen web site të RASH-it.</i>			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Departamenti i Matematikës, GVJ evidenton se programi i studimit Bachelor Matematikë është ngritur në përputhje me kuadrin përkatës ligjor, VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018. Secila lëndë e këtij programi ka syllabusin përkatës, në përputhje me formatin e miratuar, që përmban informacion të detajuar mbi titullarin e lëndës, ngarkesën (leksione, seminare, labore, praktika, orët përkatëse dhe kreditet), tipologjinë e lëndës, vitin dhe semestrin kur zhvillohet.			
	Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve. Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arki vohet dosja e plotë.	Nga konstatimet e planit mësimor të programit të studimit Bachelor Matematikë, GVJ vë re se ai është pothuajse i pandryshuar (ndryshimet e propozuara ishin mbi 20% dhe nuk janë miratuar, Vendim Senati nr. 51, datë 31.10.2016, por Departamenti i Matematikës përpiqet në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojë programin e studimit duke përditësuar literaturën dhe përmirësuar metodologjinë e përcimit të dijeve.			
	Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2017-2020. Vendim Senati nr. 51, datë 31.10.2016 https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2017/12/Vendim-senati-Nr.51-dt.31.10.2016.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ vë re respektimin e parashikimeve ligjore në lidhje me ngarkesën e programit të studimit Bachelor Matematikë dhe konkretisht programi është strukturuar sipas Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin

	<p>shkencor në IAL”, nenet 69, 70, 73; VKM 41. dt. 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”.</p> <p>Referuar planit mësimor figurojnë lëndët e të gjitha disiplonave matematikore.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2017-2020.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Referuar Planit Mësimor, Syllabuseve të lëndëve dhe Suplementit të Diplomës Bachelor në Matematikë rezultojnë se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve janë hartuar me qëllim që tu mundësojnë studentëve formim të plotë në fushën e matematikës edhe punësimin në një shkallë të gjerë pasi të kenë përfunduar programet master i shkencave ose master profesional.</p> <p><i>Vlerësohet si disavantazh mospunësimi me një diplomë Bachelor në Matematikë, kjo evidente edhe për programe studimi të ngjashme brenda vendit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Referuar Planit mësimor të programit Bachelor Matematikë, GVJ evidenton se ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, për çdo lëndë është e përcaktuar saktë në bazë të krediteve që ka secila tyre. Në këtë program studimi të gjitha lëndët kanë raportin 3:2, 2:2 ose 2:1 (3 orë leksione në javë në auditor dhe 2 orë seminare/ushtrime/laboratore).</p> <p><i>GVJ evidenton se në disiplinat matematikore zhvillohen vetëm leksione dhe seminare dhe sugjeron që të shtohen edhe orë laboratorike, sidomos në lëndët Probabilitet-Statistikë dhe Analizë Numerike të cilat mundësohen nëpërmjet softveve kompjuterike.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Matematikës, si Planin Mësimor dhe Suplementi i diplomës i programit të studimit Bachelor Matematikë si dhe diskutimin “online” me anëtarët e departamentit konstatohet se ky program studimi është i strukturuar në mënyrë të ngjashme jo vetëm me programet e të njëjtit profil brenda vendit por edhe me programe të ngjashme ndërkombëtare, në përputhje me sistemin Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Ngarkesa semestrale është e ekuilibruar për sa i përket shpërndarjes së lëndëve dhe ngarkesa totale vjetore është 60 kredite dhe lëndët variojnë me kredite nga 3 në 8.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2017-2020. Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në gjetjet e GVJ në listën e dokumentacioneve si dhe nga takimi me stafin akademik dhe administrativ të njësive kryesore dhe njësive bazë, u arrit në përfundim se programi i studimit Bachelor Matematikë është ndarë sipas veprimtarive formuese në masën: lëndët bazë 32 kredite, lëndët karakterizuese 98 kredite, lëndët ndërdisiplinore dhe integruese 24 kredite, lëndët plotësuese 20 kredite dhe detyrime përmblylëse 6 kredite.</p>

	<p>Kjo ndarje është e drejtë pasi tregon predispozitën institucionale për të favorizuar dhe nxitur transferimin e krediteve nga një program studimi jo detyrimisht i profilit Matematikë, pasi lëndët bazë përbëjnë 32 kredite dhe numri minimal i krediteve për kryerjen e transferimit është 30 kredite. <i>Studentët e ciklit të parë në Matematikë kanë qenë të përfshirë në programin “Erasmus +”, por nuk vihet re trend për ardhje studentësh me anë të transferimit të studimeve apo për punësim pas përfundimit të studimeve.</i></p>				
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se modeli i përdorur për hartimin e syllabuseve, në programin e studimit Bachelor Matematikë përmban të gjithë elementet sipas përcaktimeve VKM nr. 41, Dt.24.01.2018: Pika 2.8. Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë të detyrueshme dhe literaturë ndihmëse.</p> <p><i>Vihet re një përpjekje e stafit akademik të departamentit për përdorimin e literaturës bashkëkohore megjithatë ka vend për përmirësim.</i></p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2017-2020.</p>				
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ vlerëson përmbushjen e këtij kriteri dhe gjykon se përmbajtja e programit të studimit garanton dhe është në përputhje të plotë me përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e çdo lënde në këtë program.</p>				
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Referuar Planit mësimor dhe përcaktimeve në Suplementin e diplomës për programin e studimit Bachelor Matematikë, GVJ gjykon se përmbajtja e programit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin Master Profesional ose Master i Shkencave në Universitetin e Vlorës ose në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Destinacioni më i mundshëm i studentëve të diplomuar në Bachelor Matematikë është mësuesia dhe vlen të përmendet fakti që tashmë “Mësuesia“ është profesion i rregulluar dhe përveç përfundimit të programit master nevojitet edhe licensimi.</p> <p><i>GVJ sugjeron që nevojitet një strategji specifike për tërheqjen e studentëve si dhe një studim i tregut të punës me qëllim propozimin e mekanizmave që do të rrisnin numrin e studentëve në ciklin e parë dhe interesin e tyre për të vijuar përsëri studimet e ciklit të dytë në botë në njëjtin universitet.</i></p>				
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Nga informacioni dhe takimi i zhvilluar me NJSBCVI, GVJ arriti në përfundimin se ekzistojnë përpjekje të vazhdueshme me qëllim përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës nëpërmjet ndarjes së eksperiencave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Sektorit të kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve. Evidencë është ëorkshop “Studentët dhe tregu i punës” ku kanë marrë pjesë bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm, biznese, institucione publike e private si punëmarrësit kryesor të studentëve të Universitetit të Vlorës.</p> <p>https://univlora.edu.al/2019/12/22/workshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes/</p>				
	<table border="1"> <tr> <td>Në përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Shkalla e përbushjes së
standardit

X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik me kohë të plotë që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në Matematikë i plotëson të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. Personeli akademik me kohë të plotë që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore.</p> <p>Në talemën e ngarkuar figurojnë 17 staf akademik, por aktualisht janë 15 staf akademik, pasi dy janë larguar dhe konkretisht në faqen e UV dhe në RVB janë 15 pedagogë me kohë të plotë.</p> <p>Në programin e studimit Bachelor në Matematikë për vitin akademik 2019-2020, japin mësim 2 Profesorë të Asociuar, 8 Doktorë shkencash dhe 7 Master i Shkencave.</p> <p><i>Ngarkesa e ulët mësimore nuk mudëson angazhimin e stafit akademik të fuar.</i></p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/stafi-akademik-departamenti-i-matematikes/</p>
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<p>Evidencat e dorëzuara vërtetojnë se personeli akademik me kohë të plotë që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit (përgjegjësi i departamentit zotëron titullin Profesor i Asociuar), drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit (stafi akademik është ka një kualifikim të një shkallë më lart).</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/stafi-akademik-departamenti-i-matematikes/</p>
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë që angazhohen në mësimdhënie kanë të gjitha kualifikimet e nevojshme në disiplinat që ato mbulojnë. Ndarja e tyre në grupet mësimore-kërkimore përputhet me kualifikimet e tyre.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/stafi-akademik-departamenti-i-matematikes/</p>
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e	<p>GVJ konstaton se në programin e studimit Bachelor Matematikë nuk është e parashikuar praktikë profesionale.</p>

mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.				
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga takimi GVJ evidentoi se në funksion të programit të studimit Bachelor Matematikë përdoren laboratorë të cilët mundësojnë formimin praktik të studentëve. Gjatë këtyre orëve krahas pedagogut të lëndës asistojnë edhe stafi ndihmës akademik që janë përgjegjës për këto laboratore. Në këtë program studimi laboratore zhvillohen kryesisht në lëndët si Informatika dhe Fizika ku asiston edhe stafi ndihmës përkatës (2 staf ndihmës akademik në laboratorët përkatës).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Referuar Plani Strategjik 2018-2024 të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë si dhe “Udhëzuesit në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies”, rezulton se IAL e ka përmbushur detyrimin e saj institucional për shfrytëzimin e metodave inovative. Përdorimi sistemit UVMS është një evidencë për vënien në zbatim të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mbarëvajtjen administrative ndërmjet stafit dhe strukturave të nënsisë, por mbi të gjitha ndërmjet pedagogëve dhe studentëve. Evidenca: Plani Strategjik 2018-2024. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Matematikës bisedat “online” me personelin akademik dhe ndihmës akademik të departamentit, si edhe me studentët që ishin të pranishëm në

<p>të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>takim konstatohet se monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i aftësisë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik kryhet nëpërmjet Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJVSBCI). Kjo njësi është ngritur në rang universiteti dhe shpërndahet nëpër fakultete dhe departamente. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion vihet re se monitorimi dhe vlerësimi nga kjo strukturë mbështetet në udhëzimet e ASCAL dhe bazohet në analizën statistikore të informacioneve të përfuara nga pyetëtorët me studentët.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/vendim-nr-8.pdf https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2017/12/Vendim-senati-Nr.84-dt-12.12.2016.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në “Raporti mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019”, GVJ gjykon se studentët e programi të studimit Bachelor Matematikë përfshihen në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve nëpërmjet, pjesëmarrjes së studentëve në procesin e anketimit për çdo lëndë si dhe garantimit të të drejtës së studentit për ankimin e rezultatit të vlerësimit të dijes.</p> <p><i>Rekomandohet që njësia të përfshijë një pyetësor më specifik vetëm për studentët e Bachelor Matematikës, ku të vlerësohen përveç aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik edhe mbështetja e stafit ndihmës akademik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në përshkrimet e dhëna në dy kriteret e mësipërme rezultojnë se NJVSBC i publikon rezultatet e vlerësimit mbi bazë universiteti. Nga biseda me stafin akademik dhe përgjegjësen e departamenti, GVJ konstatoi se analiza vjetore e njësisë diskutohet në një mbledhje të hapur departamenti.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Shtojca-3-Fakulteti-i-Shkencave-Teknike-dhe-Natyrore.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ gjykon se përmbushja e këtij kriteri garantohej nga diskutimet e hapura në departament, të cilat promovojnë praktikatat pozitive dhe kjo shërben si një eksperiencë për cilindo që duhet të performojë më mirë. Një fakt konkret që na u evidentua nga takimi me stafin akademik dhe Përgjegjësen e Departamentit është mbështetja financiare që institucioni ofron në pjesëmarrjen në konferenca dhe trajnime si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Përfitimi nga aktivitete të tilla motivon, inkurajon stafin akademik për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Evidenca: Raporti vjetor i Punës për periudhën Tetor 2018-Shtator 2019 në Departamentin e Matematikës Analiza e Punës Janar 2017-Dhjetor 2017 në Departamentin e Matematikës</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në Syllabuset Bachelor në Matematikë, “Udhëzuesin në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies” dhe bisedat “online” me personelin akademik të departamentit, si edhe me studentët u konstatua se format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë; VKM 41, dt. 24.01.2018) dhe kategorizohen në leksione, seminare, laboratore, detyra kursi/projekte, leksione të hapura nga profesorë të ftuar. etj.</p> <p>Në programin e studimit Bachelor Matematikë nuk ka të përfshirë Praktikë Profesionale.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2017-2020.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>GVJ gjykon se përmbushja e këtij kriteri nga stafi i Departamenti të Matematikës garantohej nga takimi me studentët, të cilët shpreheshin për një gatishmëri të pedagogëve për t’ju afruar skema dhe metodologji inovative, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi, dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> <p>Një vlerësim sasior në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri gjendet në raportin e pyetësorëve të studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Bazuar në shkëmbimet Erasmus+ (<i>International Credit Mobility në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, Prof. Monica Motta 2017; International Credit Mobility në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë Prof. Carlo Mariconda, 2018; Lista e mobiliteteve të stafit akademik të FSHT-së</i>) GVJ gjeti dëshmi që institucioni nxit pedagogët në kryerjen e shkëmbimit për trajnimeve dhe mësimdhënies kryesisht me IAL Italiane. Nga dokumentacioni si dhe nga biseda me stafin akademik të departamentit, mbështetja e institucionit garantohej edhe nëpërmjet financimit total të pjesëmarrjes në konferenca shkencore jashtë vendit.</p> <p>Evidenca: Lista e mobiliteteve të stafit akademik të FSHT-së. International Credit Mobility në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë (Prof. Monica Motta) 2017 International Credit Mobility në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë (Prof. Carlo Mariconda), (Shkresë Përcjellëse) 2018</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se stafi akademik i Departamentit të Matematikës ka në përbërje të tij pedagogë të kualifikuar në drejtimet kryesore të matematikës, që përkon edhe me grupet mësimore-kërkimore ku ato bëjnë pjesë. Nga gjetjet në Bibliotekën e universitetit, në seksionin e titujve për matematikës, rezulton se testet që përdoren janë bashkohore.</p> <p>GVJ arrin në përfundimin se ky kriter përmbushet plotësisht dhe ekziston vullneti i stafit për të vijuar më tej kualifikimet.</p> <p>Evidenca: https://uni.vlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Shtojca-3-Fakulteti-i-Shkencave-Teknike-dhe-Natyrore.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Matematikës (<i>Raporti i pyetësorit</i>) dhe bisedat “online” me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se stafi i Departamentit të Matematikës diskuton në mënyrë periodike përmirësimin e formave të mësimdhënies, duke konsideruar kërkesat, rekomandimet dhe sugjerimet e studentëve.</p> <p>Gjatë bisedave online studentët u pyetën nëse e kanë ndier disnivelel midis shkollës së mesme dhe programeve të disiplinave kryesist të Analizës matematike dhe Gjeometrisë dhe ato u shkrehën se kanë gjetur gadishmërinë e pedagogëve për tju përshtatur nivelit të tyre edhe duke shtuar disa leksione ndihmëse sipas nevojës.</p> <p>Evidenca: Raporti vjetor i Punës për periudhën Tetor 2018-Shtator 2019 në Departamentin e Matematikës Analiza dhe vlerësimi i pyetësorit të studentëve për vitin akademik 2018-2019 Plani i masave DM që ka dalë nga pyetësori</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga konstatimet GVJ evidentoi se stafi i Departamentit të Matematikës është gjithmonë i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi. Evidencë për këtë janë tekstet dhe literatura që përdoret, si ajo që gjendet fizikisht në bibliotekë ashtu edhe leksionet e depozituara në departament. Konkretisht Analiza Numerike shoqërohet me programim në MATLAB.</p> <p><i>GVJ sugjeron përfshirjen e më shumë orëve laboratorike në mësimdhënien e disa lëndëve aplikative të cilat janë të shoqëruara me softe për implementimin e metodave dhe teknikave të ndryshme.</i></p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe</p>	<p>Bazuar në bisedat “online” me personelin akademik të Departamentit të Matematikës dhe studentët u konstatua se metodat e mësimdhënies e inkurajojnë sensin e autonomisë tek studenti. Komunikimi i vazhdueshëm i stafit akademik me studentët ndihmon në ndërtimin e marrëdhënieve të</p>

ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	respektit të ndërsjellë pedagog-student, kryesisht gjatë orëve të konsultimeve të cilat planifikohen nëpërmjet postës elektronike në domainin @univlora.edu.al.		
	<i>Nga biseda me studentët u vu re se falë këtij komunikimi nuk është ndier mangësi edhe nga mësimi në distancë gjatë periudhës së pandemisë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Referuar “ <i>Kapaciteteve akademike dhe fizike të FSHT-së</i> ” si dhe nga konstatimit gjatë vizitës online, GVJ gjykon se hapësirat ku realizohet procesi mësimor i programit të studimit Bachelor në Matematikë, zhvillohet pranë ambienteve të Fakultetit të Shkencave Teknike. Këto ambiente janë në një godinë kryesore, Godina C është e organizuar në 5 kate dhe ka në përbërje të saj: Salla leksionesh dhe 14 salla seminaresh, 6 laboratorë për zhvillimin e lëndëve të ndryshme si: Informatikë, Statistikë, Fizikë. <i>GVJ sugjeron gjetjen e politikave për rekrutimin e një numri më të madh studentësh sepse raporti student/ m² referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 është larg standartit të përcaktuar.</i> Evidenca: Kapacitetet akademike dhe fizike të FSHT-së.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Nga evidencat e paraqitura (“ <i>Kapacitetet akademike dhe fizike të FSHT-së</i> ”, Tabela 16-Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë) si dhe nga konstatimet e vërejtura në takimin e zhvilluar rezulton se FSHT/ Departamenti i Matematikës zotëron në sasi të mjaftueshme ambiente, salla, zyra, studio dhe laboratorë të nevojshëm për realizimin e programit të studimit Bachelor në Matematikë. Ambientet ku zhvillohet mësimi (auditorë, salla leksionesh), janë të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor me të gjithë komponentët e ti, leksione, seminare, laboratore. Një numër i konsiderueshëm sallash janë të pajisura me video-projektorë dhe kanë lidhje interneti. Edhe në këtë kriter vlen sugjerimi i dhënë ne Kriterin 1.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	GVJ konstatoi se personeli akademik i FSHT-së i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në Matematikë si edhe studentët të cilët ndjekin këtë program studimi, disponojnë një sistem informatik të konsoliduar dhe konkretisht, platforma digjitale “ <i>Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Mësimor të UV-së</i> ” (UVMS_University of Vlora Management System); të gjithë stafi dhe studentët përdorin adresat zyrtare të email-it (emër.mbiemër@univlora.edu.al) nëpërmjet të cilave kanalizohet

	<p>komunikimi zyrtar dhe në funksion të procesit mësimor, si për shembull dhënia e detyrave të kursit, caktimi i orareve të konsultimit, dhënia e notave, etj.</p> <p>Laboratori i IT, i cili është i destinuar për zhvillimin e orëve laboratorike si dhe të seminareve për lëndët me karakter informatik është i pajisur me kompjutera, të cilët kanë të instaluar programet dhe gjuhët e programimit që studentët zhvillojnë në kurrikulën e matematikës.</p> <p>Evidenca: Kapacitetet akademike dhe fizike të FSHT-së Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga konstatimet e syllabuseve si dhe gjendja e librave në bibliotekë, GVJ evidentoi se literatura bazë për çdo lëndë të programi të studimit Bachelor Matematikë është në gjuhën shqipe, kryesisht me tekste dhe shumë pak me leksione të shkruara.</p> <p>Nga vizita e kryer në bibliotekën e fakultetit, u vu re se gjenden afërsisht 200 tituj për disiplinat e ndryshme të matematikës. Sallat e bibliotekës janë të organizuara me fonde të hapura të ndara sipas disiplinave të matematikës, Analizë Matematikë, Algjebër, Probabilitet Statistikë dhe Analizë Numerike.</p> <p>Evidenca: Kapacitetet akademike dhe fizike të FSHT-së Titujt: Biblioteka e UV.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita e zhvilluar GVJ konstatoi se në bibliotekën e Godinës A dhe C janë vënë në dispozicion të studentëve tekste mësimore të përcaktuara në syllabus-et e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme kryesisht në gjuhë angleze. Biblioteka ka një fond rreth 723 tituj (në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja) për të gjitha fushat që mbulon FSHT. Biblioteka e FSHT me një sipërfaqje të ambienteve rreth 80 m² është e hapur nga e hëna në të premte 08:00–16:00.</p> <p>Evidenca: Titujt: Biblioteka e UV.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, sa i takon aksesimit të librarive on-linë, ekziston vetëm një marrëveshje institucionale nëpërmjet Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) https://univlora.edu.al/biblioteka/ dhe https://ulibrary.rash.al/</p> <p><i>Nuk ka evidenca se sa shpesh studentët apo personeli akademik aksesojnë këtë librari dhe se sa i përmbush ajo nevojat e tyre.</i></p> <p>Evidenca: Titujt: Biblioteka e UV. https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2017/12/Vendim-Senati-Nr.83-date-18.07.2017.pdf Të dhëna të plota për platformat online.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet</p>	<p>Nga takimi me studentët si dhe nga dokumentacioni i shqyrtuar, u konstatua se studentët kanë akses të vazhdueshëm në ambientet e laboratoreve kompjuterike dhe madje mund t'i përdorin ato edhe për të kryer detyra</p>

në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	kursesh dhe përpunime të ndryshme statistikore në funksion të përmbushjes së detyrimeve akademike.								
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	GVJ arriti në përfundimin se studentët dhe pedagogët e Departamentit të Matematikës janë shumë fleksibël në përdorimin e sistemit informatik “Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Mësimor të UV-së” për komunikim akademik dhe administrativ me anë të sekretarisë mësimore. Periudha e pandemisë është një tjetër tregues për efikasitetin e komunikimit nëpërmjet mjeteve të ICT. Përveç sistemit të brendshëm për ngarkimin e leksioneve, seminareve apo materiale të tjera plotësuese, është përdorur Google Meet për të zhvilluar mësimin on-line gjatë kushteve të pandemisë. Evidenca: Rregullore e Brendshme e FSHT-së Manuali i përdorimit të sistemit UVMS								
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	GVJ nga evidencat e dokumentacionit si dhe nga takimi i zhvilluar me stafin akademik, ndihmës akademik, administrativ si dhe studentët kanë një adresë zyrtare në domainin @univlora.edu.al. Nëpërmjet link-ut https://uvms.univlora.edu.al/user/login , studentët kanë akses në hapësirën e tyre personale elektronike. Nëpërmjet kësaj hapësire studentët regjistrohen në provimet e sezonit dhe aksesojnë lehtësisht materialet e ngarkuara nga titullarët e lëndëve. Evidenca: Manuali i përdorimit të sistemit UVMS								
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion (<i>Rregullore e diplomimit të FSHT-së, Neni 4,7,8,9; Formulari i përcaktimit të temës së diplomës</i>) studentët ndjekin një praktikë të mirëpërcaktuar për përzgjedhjen e temave të diplomave, i cili fillon që në fillim të semestrit të pestë ose vitit të tretë dhe i rregullar me anë të Rregullores së diplomimit, ku gjatë punës së diplomës studenti dhe pedagogu i nënshtrohen një grafiku takimesh dhe punimi kalon në proces mbrojtjeje nëse miratohen nga udhëheqësi i diplomës. Evidenca: Rregullore e Programit të Ciklit të parë të Studimit Bachelor në Matematikë, Neni 25 Rregullore e diplomimit të FSHT-së, Neni 4,7,8,9 Formulari i përcaktimit të temës së diplomës								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të	GVJ referuar dokumentacionit (<i>Statuti i UV-së; https://univlora.edu.al/aktivitete/</i>) evidentoi se në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies IAL ka ngritur Strukturën e Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi funksionon në nivel institucional.

<p>mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>NJSBC koordinon dhe bashkërendon aktivitetet e saj me njësitë kryesore dhe ato bazë. Në këtë kuadër janë përpiluar pyetësorët e studentëve të cilat synojnë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Analiza e pyetësorëve identifikon më tej pikat e forta dhe të dobëta.</p> <p><i>Konstatohet se janë kryer pyetësorë vetëm për 2 (dy) vitet e fundit akademike dhe është hartuar raport vetëm për pyetësorin e fundit.</i></p> <p>Evidenca: Statuti i UV-së, Neni 22, 81, 82 https://uni.vlora.edu.al/aktivitete/ https://uni.vlora.edu.al/2019/12/22/workshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes/</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Referuar raportit të publikuar nga NJSBC dhe takimit të organizuar në UV, GVJ konstatoi se Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Departamenti i Matematikës, në mënyrë specifike strukturat përgjegjëse: Zv/Dekani për anën akademike, Drejtuesi i Departamentit, si dhe Drejtuesi i Grupit Mësimor janë përgjegjës dhe bashkërendojnë procesin për kontrollin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Evidenca: Urdhëri 123 datë 19.12.2019, “Ngritjen e grupit të punës për përmirësimin e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UV”. Urdhëri 31 datë 11.04.2019, “Ngritjen e grupit të punës për pilotimin e draft-pyetësorit të studentëve për vlerësimin e shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ/ndihmës akademik në UV. Udhëzuesi mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ gjykon se ky kriter përmbushet me propozimin e Qendrës Studimore Ndërdisciplinore, e cila ofron trajnime profesionale të edukimit të vazhdueshëm për universitetin. Miratimi i “Udhëzuesit mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit”, shërben si një nxitje për stafin akademik në përgjithësi dhe atij të Departamentit të Matematikës në veçanti për të përditësuar teknikat e mësimdhënies dhe për të eksperimentuar skema të reja.</p> <p><i>Rezultatet duhet të shihen në një periudhë 5 vjeçare.</i></p> <p>Evidenca: Urdhëri 123 datë 19.12.2019, “Ngritjen e grupit të punës për përmirësimin e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UV”. Udhëzuesi mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për</p>	<p>GVJ nga evidencat e aktivitetit kërkimor dhe shkencor të personeli akademik të Departamentit të Matematikës evidenton si ai kualifikohet në mënyra të vazhdueshme sipas fushave të kërkimit shkencor të cilave ato ju përkasin. Institucioni ka garantuar mbulimin financiar të pjesëmarrjeve në konferenca</p>

të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	ndërkombëtare dhe botime në revista shkencore, gjë e cila ka nxitur kualifikimin shkencor të stafit akademik.			
	Evidenca: Raporti Vjetor i punës për periudhën Tetor 2018- Shtator 2019 në DM Rimbursimi i personelit akademik për kërkimin shkencor në DM Strategjia për trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesëve të rinj			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Një evidencë e qartë për përmbushjen e këtij kriteri GVJ gjen mbështetjen e institucionit për personelin akademik në pjesëmarrje në projektet kërkimore e në mënyrë të veçantë në mobilitetet Erasmus +, kjo drejtpërdrejt ndikon në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Një evidencë e dytë janë trajnimet e LLL të ofruar nga Qendra Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal (RDC)			
	Evidenca: Lista e mobiliteteve të stafit akademik të FSHT-së Relacion mbi Workshop-et në DM, 2018 dhe 2019			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Për përmbushjen e këtij kriteri referuar dokumentacioneve të vëna në dispozicion si dhe diskutimeve të organizuara me stafin akademik të Departamentit të Matematikës nuk ka evidencë të qarta dhe të matshme që të evidentojnë plotësimin e këtij kriteri.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Referuas sa është shkruar në plotësimin e Kriterit 6 si dhe diskutimeve të organizuara me stafin akademik të Departamentit të Matematikës nuk ka evidencë të qarta dhe të matshme që të evidentojnë plotësimin e këtij kriteri.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mbështetur në dokumentacionin e miratuar nga UV siç janë: <i>Rregulloren e Universitetit</i> , e cila është e publikuar online në faqen zyrtare të Universitetit (https://univlora.edu.al/rregullorja); <i>Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë</i> dhe <i>Rregullorja e Departamentit të Matematikës</i> janë të përcaktuara kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive e dijeve dhe aftësive profesionale. Studentët orientohen nga Këshilltari akademik se ku mund të gjejnë këtë informacion, orientohen prej sekretareve, zyrës së studentit në rrjete të ndryshme sociale.

	<p>Evidenca: Rregullore e FSHT-së, Kreu VI, Neni 24, 25,26,27 Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës, Neni 19 Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë, Neni 21 2.1: Syllabuset Bachelor në Matematikë Rregullore e UV-së, Kreu VII: Kontrolli i dijes dhe Kreu VIII, Neni 65 https://univlora.edu.al/rregullorja</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Departamenti i Matematikës dhe veçanërisht nga takimi me studentët e programit Bachelor Matematikë konstatoi se këto të fundit prezantohen me njohjen e kriterëve dhe mënyrave të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale që në orën e parë të çdo lëndë/moduli me prezantimin e syllabusit prej pedagogut të lëndës.</p> <p>Evidenca: Rregullore e UV-së, Kreu VII: Kontrolli i dijes dhe Kreu VIII, Neni 65 https://univlora.edu.al/rregullorja Syllabuset Bachelor në Matematikë</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Referuar syllabuseve të secilës lëndë ku përshkruhen në detaje format e testimit dhe vlerësimit të dijeve, përgjithësisht GVJ gjykon se formati i syllabusit është konform VKM 41 dhe studentëve ju ofrohen mënyra të ndryshme të testimit. Ka lëndë që vlerësohen me vlerësim të vazhdueshëm, por dominojnë ato me vlerësim me provim, por vlerësimi është ndarë në përqindje proporcionale, ku vlerësohet frekuentimi, aktivizimi dhe kontrollat e pjesshme, skema që u japin studentëve mundësinë për të demonstruar njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të lëndës ose modulit.</p> <p>Evidenca: Rregullore e UV-së, Kreu VII: Kontrolli i dijes dhe Kreu VIII, Neni 65 https://univlora.edu.al/rregullorja Syllabuset Bachelor në Matematikë</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Referuar “Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës”, “Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë” dhe syllabuseve të lëndëve si dhe nga bidesa që GVJ zhvilloi me stafin akademik të departamentit konstatoi se në përgjithësi vlerësimi i studentit ndahet në tre pjesë: provimi i pjesshëm me peshë që varion nga 25-30%, 10-15% vlerësimi i detyrave të kursit dhe provimi përfundimtar rreth 60%.</p> <p>Evidenca: Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë, Neni 21 Syllabuset e programit Bachelor në Matematikë</p>



<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ nuk gjeti evidenca për ekzistencën e një sistemi elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve. Plotësimi i këtij kriteri mbetet një sfidë për IAL.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga kontrolli i disa procesverbaleve të vëna në dispozicion nga Kryetarja e Degës Mësimore, GVJ arriti në konkluzionin se komisionet e provimeve përbëhen nga 2 (dy) anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. Tezat e provimeve përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm siç janë emri i studentit/tes, kodi i lëndës, emri i pedagogut, pikëzimin e pyetjeve etj. Tezat e provimeve hartohen nga titullari i lëndës dhe firmosen nga Përgjegjësjja i departamentit.</p> <p>Evidenca: Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë, Neni 21</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Referuar <i>Rregullores së UV/FSHT</i> nga GVJ u vu re se testimi dhe vlerësimi i njohurive që realizohen me shkrim, zhvillohet në orën dhe sallën e caktuar ku çdo studenti i shpërndahet teza e provimit e hartuar nga titullari i lëndës.</p> <p><i>GVJ nuk gjen evidenca për sekretimin dhe kodifikimin e provimeve.</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Referuar <i>Rregullores së UV/FSHT</i>, dhe takimeve “online” me studentët, pas përfundimit të provimit, studenti/tja ka të drejtë të ri-shikojë provimin dhe vlerësimin e dhënë nga titullari i lëndës. Vlerësimet janë të shoqëruara me komente dhe këshilla që e ndihmojnë studentin/ten në procesin e të nxënës.</p> <p>Evidenca: Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë, Neni 21 https://uvms.univlora.edu.al/pedagog</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Bazuar në <i>Rregulloren e UV</i>, <i>Rregulloren e Departamentit të Matematikës</i>, <i>Rregulloren e programit të studimit</i> si dhe <i>Kodin e Etikës së UV</i>, në rastet e konstatimeve të kopjimeve në provime apo detyrat e kursit, personeli akademik i tërheq studentit/tes vërejtje me gojë dhe i zeron pikët e vlerësimit.</p> <p>Evidenca: Rregulloren e UV. Rregulloren e Departamentit të Matematikës, Rregulloren e programit të studimit. Kodi i Etikës i Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, Neni 8, pika 6 dhe 8; Neni 9, pika 8 dhe 9.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Referuar <i>Rregullores së programit të studimit Bachelor Matematikë</i> si dhe <i>Kodin e Etikës së UV</i> dhe takimeve “online” me studentët konstatohet se ata mund të marrin vlerësimin e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale brenda 48 orëve nga dita e zhvillimit të provimit. Rezultat e provimeve</p>

	<p>hidhen në sistemin elektronik UVMS duke siguruar në këtë mënyrë konfidencialitetin e rezultatit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që në pyetësorët e hartuar të ketë pyetje të cilat marrin gjykimin e studentit në lidhje me rezultatet e kontrollit si dhe një analizë sasiore në lidhje me këtë çështje.</i></p> <p>Evidenca: Rregulloren e UV. Rregulloren e Departamentit të Mateamtikës, Rregulloren e programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga takimi me studentët arriti në përfundimin se studentët njihen me vlerësimin sipas formave të përcaktuara në syllabusin e lëndës, dhe në raste paqartësish, ata shikojnë personalisht provimin në prezencë të lektorit të kursit, në raste mosdakortësie i drejtohen me anë të një kërkesë me shkrim përgjegjëses së departamentit.</p> <p>Evidenca: Rregulloren e UV. Rregulloren e Departamentit të Mateamtikës, Rregulloren e programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sa u shpreh në Kriterin 8 si dhe referuar përcaktimeve për raste ankimesh dhe ngritjen e kominsioneve të posaçme të shprehura në <i>Rregulloren e FSHT</i>, studenti ka të drejtë të ankimojë në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Nëse Përgjegjësi i Departamentit merr një kërkesë ankimi, duhet që brenda 48 orëve ti japë përgjigje ankimit, në rast të kundërt ia drejtoj ankimit Dekanit, i cili ngre një komision ad-hoc dhe kryen shqyrtimin e rastit.</p> <p>Evidenca: Rregullore e FSHT, Neni 26, 27.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Referuar <i>Kurrikula Bachelor Departamentit Matematikës 2017-2020, Syllabuset e programit Bachelor në Matematikë</i>, GVJ arriti në konkluzionin se programi i studimit Bachelor në Matematikë është i hartuar për arsimimin profesional dhe formimin shkencor të studentëve në të gjitha disiplinat e matematikës, Analizë matematikë, Algjebër, Gjeometri, Probabilitet, Statistikë dhe Analizë numerike. I gjithë programi është realizohet në 24 lëndë dhe synon thellimin e njohurive dhe aftësimin profesional të tij.</p>

	<p>Evidenca: Kurrikula Bachelor DM 2017-2020 Syllabuset e programit Bachelor në Matematikë.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Referuar Kurrikulës së programi të studimit Bachelor Matematikë vihet re një ndërthurjeje e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, dhe plotësuese. Në Planin mësimor të programit në fjalë gjenden lëndët Teknologjisë së Informacionit , Fizikë dhe Gjuhë e Huaj.</p> <p><i>GVJ sugjeron përfshirjen e lëndëve me karakter ekonomik, me qëllim që studentëve tu jepet mundësi e diversifikimit të studimeve në ciklin e dytë.</i></p> <p>Evidenca: Kurrikula Bachelor DM 2017-2020 Syllabuset e programit Bachelor në Matematikë.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Nga konstatimet e syllabuseve dhe takimet online me studentët GVJ vë re se studentët marrin informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që duhet të përfitojnë ato në lëndën përkatëse. Një informacion përmbledhës në lidhje me përgatitjen për vlerësimin përfundimtar kryeht në javën e fundit të semestrit si dhe në orët e konsultimeve që cakton secili pedagog.</p> <p>Evidenca: Kurrikula Bachelor DM 2017-2020 Syllabuset e programit Bachelor në Matematikë.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Referuar diskutimit me studentët gjatë takimit GVJ konstaton së në përfundim të çdo lënde pedagogu informon studentin për vlerësimin gjithëvjeter dhe i orienton për provimin përfundimtar. Vlerësimi gjithëvjeter i studentit është i përcaktuar në syllabusin e lëndës.</p> <p>Evidenca: Kurrikula Bachelor DM 2017-2020 Syllabuset e programit Bachelor në Matematikë.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Evidencë për përbushjen e këtij kriteri janë leksionet e hapura të mbajtura nga profesorët Prof. Monica Motta dhe Prof. Carlo Mariconda nga Universiteti i Padovës ku është përcjellë një nga eksperiencat më të mira Europiane në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Këto mobilitete janë zhvilluar në dy vite akademike, 2017 dhe 2018.</p> <p>Evidenca: Relacion mbi Ëorkshop-et në DM, 2018 dhe 2019.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Syllabuset e programit të studimit Bachelor në "Matematikë" rezultojnë të kenë të përfshira rezultatet e të nxënit në formën kompetencave që studenti/tja fiton gjatë zhvillimit të lëndëve të caktuara dhe konkretisht për disa lëndë përveç informacionit teorik studentet testojnë njohuritë e tyre me anë të realizimit të detyrave të kursit ose programeve të shkurtra kompjuterike në lëndët Informatikë, Probabilitet dhe Statistikë, dhe Fizikë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të shtohen lëndët ku mund të kryhen laboratore, pasi tashmë janë të mundshme në disa gjuhë apo softe kompjuterike.</i></p> <p>Evidenca: Kurrikula Bachelor DM 2017-2020</p>

	Syllabuset e programit Bachelor në Matematikë.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Në takimet e zhvilluara me studentët evidentohet se pedagogët mbështesin diskutimet dhe punën në grup të studentëve. Komunikimi i tyre është inkurajues dhe konstruktiv, kjo falë edhe numrit të vogël të studentëve, gjë e cila e favorizon në këtë rast.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Në mbështetje të asaj që u shpreh në Kriterin 7 efidencë për krijimin e një klime të përshtatshme dhe bashkëpunuese ndërmjet stafit akademik dhe studentëve është paraqitja e punëve të diplomave në konferenca kombëtare (<i>Dosja e konferencave NRA CSIT</i>) apo mbështetja e studentëve në kryerjen e shkëmbimeve kryesisht Erasmus+.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Në vijim të argumentave të dhëna në Kriteret 7 dhe 8, GVJ u informua se studentët kanë zhvilluar një Konferencë studentore në vitin 2017 në UV https://univlori.edu.al/en/2017/11/10/thirrje-per-konference me synimin për të dhënë zgjidhje inteligjente për probleme të ndryshme që prekin fusha të ndryshme. Në kuadër të mjaft marrëveshjeve të bashkëpunimit “Erasmus +” studentët kanë kryer shkëmbime në universitete partnere në Itali. <i>Studentet nuk janë të përfshirë në projekte kërkimore.</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ gjeti evidenca për kryerjen e mobiliteteve në kuadër të programit Erasmus+, dhe konkretisht dy studentë nga Kursi i 3-të i Matematikës kanë kryer një shkëmbim në Padova, Itali. Fleksibiliteti në procesin e ekuivalentimit “ <i>Ekivalentimi dhe vlerësimi i lëndëve të studentëve pjesëmarrës në programin “Erasmus +”</i> ” ka bërë të mundur nxitjen e aplikimit të studentëve për kryerjen e mobiliteteve. Evidenca: Ekuivalentimi dhe vlerësimi i lëndëve të studentëve pjesëmarrës në programin “Erasmus +”. Të dhënat për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Referuar Rregullores së programit të studimit Bachelor Matematikë, është konstatuar se institucioni ka një procedurë të posaçme për mbrojtjen e diplomës, me të cilën studentët njihen në fillim të semestrit të pestë dhe është publike edhe në faqen e fakultetit. Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Matematikë diplomohen me provim ose punim diplome. Periudha e diplomimit është dy herë në vit në sesionin e verës dhe në sesionin e vjeshtës. Evidenca: Procedurë Diplomimit në DM Vendim Senati Nr.9 datë 26.01.2017

	Rregullore për testimet e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit, Kreu I, Neni 2,5,6 Kreu II, Neni 8
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Në koherencë me <i>Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Matematikë</i> , sekretaria mësimore informon studentin në lidhje me shlyrjen e detyrimeve hyrëse në provimin e diplomës, ndërsa pedagogu udhëheqës ju vënë në dispozicion studentëve një material përmbledhës në lidhje me tezen e provimit të diplomës. Evidenca: Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Matematikë Rregullore për testimet e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit, Kreu I, Neni 2,5,6 Kreu II, Neni 8.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në evidencat e vënë në dispozicion “Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Matematikë”, GVJ konstaton se komisioni i posaçëm i ngritur për administrimin e provimit final formulon tezën e Provimit të Diplomës të programit të Ciklit të Parë Bachelor në Matematikë. Lista e pyetjeve të tezës bazohet në lëndët karakterizuese të programit të zhvilluara në 3 (tre) vite akademike, sipas peshës specifike në kredite që ka secila prej lëndëve. Teza firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani. Evidenca: Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Matematikë Rregullore për testimet e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit, Kreu I, Neni 2,5,6 Kreu II, Neni 8.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Nga evidencat dokumentacionale sid he nga biseda online me studentët rezulton se këto të fundit njihen me bandën e pyetjeve dhe literaturës së domosdoshme për përgatitjen për provimin e diplomës. Ky material tërhiqet nga studentët në sekretarinë mësimore ose drejtpërsëdrejti nga pedagogët gjatë seancave të konsultimit. Studentët me mesatare të lartë zgjedhin për të punuar temë diplome.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga biseda online me studentët, GVJ u informua se studentët të cilët përzgjidhen për të zhvilluar një temën e diplomës kanë mundësinë të shfrytëzojnë bazën e të dhënave (informacion/statistika) të institucioneve të tjera, kryesisht brenda Vlorës me të cilat universiteti (Fakulteti i Shkencave Teknike) bashkëpunon për realizimin e praktikave të studentëve. Evidenca: Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Matematikë.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Matematikë diplomohen me provim ose punim diplome. Provimi përmbledh njohuritë bazikë të asimiluara në tre vite akademike, nga të gjitha disiplinat matematike. Punimi i diplomës të nivelit të parë është përgatitja e një teme në një fushë të caktuar të përzgjedhur nga studenti në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës. Pedagogu udhëheqës harton një plan pune me afate të

	<p>përcaktuara të cilat studenti duhet të ndjekë me rigorozitet. Para mbrojtjes udhëheqësi miraton punimin me anë të nënshkrimit të punimit të diplomës dhe kjo i jep të drejtë studentit të kryejë mbrojtjen përpara komisionit të ngritur në departament.</p> <p>Evidencë: Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Matematikë. Procedurë diplomimi në Departamentin e Matematikës.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të procesit të provimit, komisioni hedh rezultatet me shkrim dore në proces-verbalin përkatës, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Provimit. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Për studentët të cilët mbrojtjen e diplomës e realizojnë nëpërmjet prezantimit të një teme të punuar nën drejtimin e pedagogut udhëheqës, në përfundim juria pasi merr në konsideratë vlerësimin e udhëheqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë.</p> <p>Evidencë: Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Matematikë. Procedurë diplomimi në Departamentin e Matematikës.</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar <i>Rregullores së organizimit të programit Bachelor në Matematikë</i> studentët të cilët kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare pajisen me diplomë (Diplomë Bachelor në Matematikë), certifikatën e notave dhe suplementin e diplomës (Suplementit të Diplomës Bachelor në Matematikë). Të tri këto dokumente kanë formën e tyre të miratuar nga Senati akademik i UV, dhe të regjistruar në MASR.</p> <p>Evidenca: Suplementit të Diplomës Bachelor në Matematikë Diplomë Bachelor në Matematikë</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Referuar dokumentacionit dhe praktikës së treguar nga Kryetarja e Degës mësimore gjatë takimit të zhvilluar online, si dhe në vijim të shpjegimeve të dhëna në Kriterin 8, student pasi shlyen të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, pasijet me diplomë dhe suplementin e diplomës. Në rast se ai është i interesuar për kopjen e plotë të programit të studimit që ka ndjekur i drejtohet Degës Mësimore me një kërkesë me shkrim dhe nis përgatitja e programit të plotë. Programin e plotë student i diplomuar mund ta kërkojë në raste specifike, kur i kërkohen për të ndjekur një program studimi në një cikël më të lartë, transferim studimesh, etj.</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Referuar <i>LAL 80/15, Statutin e UV-së, Rregulloren e UV-së</i>, sekretaria mësimore e departamentit dhe e FSHT-së disponojnë dokumentacionet: regjistër themeltar, regjistër të lëshimit të diplomave. Dega mësimore përgatit certifikatën e notave, ku janë të paraqitura të gjitha notat dhe të dhënat e studentit, përfshirë numrin e matrikullimit. Suplementi i diplomës është i hartuar me të gjitha elementet e përcaktuara në VKM 41. Konfirmimi i dokumentacionit, i cili kërkohet në rastet kur studentit duhet të legalizojë ose të aplikojë jashtë vendit, ndjek të gjitha hallkat ku ai ka kaluar për prodhimin e tij, në të cilat firmoset dhe vulloset.</p>

	Evidenca: Rregullore e UV-së, Neni 54, Neni 90 Statuti i UV-së, Neni 78,79, fq 45-46			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimorshkencor dhe administrativ.	Referuar <i>Statuti i UV-së, Neni 31,38,43.50; Rregullore e UV, Neni 20,25,31,33; Kuadri ligjor ku bazon veprimtarin Zyra e Burimeve Njerëzore.; Rregullore e FSHT, Neni 14,17</i> si dhe dhe takimit të zhvilluar me Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës rezulton se kjo është struktura përgjegjëse për arshivon të gjithë dokumentacionin e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, si dhe stafit ndihmës-akademik dhe administrativ të Universitetit të Vlorës. Kjo strukturë disponon dosjen e plotë për personelin e UV (CV e përditësuar, diploma, listë notash, librezë pune, kontratë pune, tituj akademik etj), ndërsa dokumentacioni i përditësuar që evidentojnë aktivitetin kërkimor shkencor të kryer nga stafi akademik siç janë: certifikata trajnimesh apo konferencash, botimeve, etj.) dorëzohet dhe ruhet në Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Publikimeve. Evidenca: Statuti i UV-së, Neni 31,38,43.50 Rregullore e UV, Neni 20,25,31,33 Kuadri ligjor ku bazon veprimtarin Zyra e Burimeve Njerëzore. Rregullore e FSHT, Neni 14,17
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Në bazë të evidencave të paraqitura (Shembull i një procedure të plotë punësimi në Departamentin e Matematikës, https://uni.vlora.edu.al/njoftime-punesimi/) Sektori i Burimeve Njerëzore ndjek të gjitha procedurat në lidhje me rekrutimet e reja bazuar përcaktimet e në paraqitura në <i>Statutin e UV Neni 51 dhe Rregullore e UV-së, Neni 27 dhe 28.</i> Evidenca: Shembull i një procedure të plotë punësimi në DM

	https://univlora.edu.al/njoftime-punesimi/ Statuti i UV-së, Neni 51.			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteretë posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullore dhe i bën ato publike.	Refruar dokumentacionit, si dhe takimeve “online” GVJ konkludon se procedurat për rekrutimin e personelit janë përcaktuar në dokumentacionet bazë, <i>Statuti UV, Rregullore UV</i> dhe vihen në funksion të veprimtarisë të IAL. Kriteret e posaçme dhe specifike për të gjitha vendet vakante përcaktohen në departament dhe shpallen në faqen zyrtare të UV pas miratimit nga Rektori. Evidenca: https://univlora.edu.al/njoftime-punesimi/ Ligji i Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015, Neni 59. Statuti i Universitetit të Vlorës, Neni 38, pika e, f, j; Neni 51. Rregullore e Universitetit të Vlorës, Neni 28 dhe 29.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteretë përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Në vijim të shpjegimeve dhe evidencave të cituara në Kriterin 2 dhe Kriterin 3 si dhe nga takimi “online” me zyrën e Drejtorisë të Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, GVJ u informua se ky sektor në bashkëpunim me njësinë bazë, është përgjegjës për ndjekjen e gjithë procedurës në lidhje me rekrutimet në Departamentin e Matematikës, në UV. Vlerësimi i kandidatëve në konkurs bëhet nga komisioni <i>Ad-hoc</i> , i cili në bazë të tabelës së pikëzimit, e përdorur për vlerësimin e dosjeve dhe e publikuar në faqen zyrtare të IAL shpall kandidatin Evidenca: https://univlora.edu.al/njoftime-punesimi/			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Referuar konstatimeve të bëra gjatë vizitës GVJ konkludon se ambientet e godinës C, në të cilën është akomoduar stafi akademik dhe ndihmës akademik i Departamentit të Matematikës është një mjedis i përshtatshëm për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Çdo anëtar i stafit akademik ka një zyrë të pozicionuar në godinën e FSHT me një post pune, të pajisur me një kompjuter dhe pajisje të tjera ndihmëse, vlen të përmendet që linja e internetit është Ëireless dhe aksesohet edhe në sallat e leksioneve dhe seminareve. Evidenca: Raporti vjetor i Universitetit të Vlorës për vitin 2018-2019.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të	Refruar <i>Plani Strategjik i UV-së 2018-2024, Strategjisë për Kërkimin Shkencor 2017-2022, Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2016-2020,</i>



personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<i>Strategjia për Trajnimin e Vazhdueshëm të Kërkuesëve të Rinj</i> , GVJ gjykon se institucioni ka treguar angazhimin e saj dhe i ka mundësuar personelit kualifikimin e mëtejshëm profesional. Përfshirja në shkëmbimet Erasmus+ është një tjetër dëshmi e vullnetit për zhvillimin profesional.			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Mbështetja e institucionit me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimin si, videoprojektorët, shërbimi i internetit, pajisja e disa sallave me Smart Board etj. ka përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe duke e bërë më tërheqëse për studentët. <i>GVJ sugjeron vënien në zbatim të “Udhëzuesi mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë”, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor.</i> Evidenca: Plani Strategjik i Univesitetit të Vlorës 2018-2024. Rimbursimi i personelit akademik për kërkimit shkencor në Departamentin e Matematikës. Aktiviteti i kërkimit shkencor të personelit akademik të Departamentit të Matematikës. Strategjia e Ndërkombëtarizimit https://univlora.edu.al/2017/12/13/strategjia-e-nderkombetarizimit/			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Sipas gjetjeve (<i>Model i Planifikimit të kohës vjetore të punës për personelin akademik në IAL publike për viti akademik 2018–2019, Raporti vjetor i UV-së për vitin 2017-2018</i>) të GVJ arrin në konkluzionin se Departamenti i Matematikës është i organizuar mirë dhe ka kapacitet të mjaftueshëm të burimeve njerëzore për të mbuluar dhe realizuar të gjithë ngarkesën mësimore dhe kërkimore të programit që ofron. Në mbështetje të realizimit të procesit mësimor, pranë programit të studimit Bachelor Matematikë angazhohen edhe pedagogë nga departamente të tjera, si ato të Informatikës, Fizikës dhe Gjuhës së huaj. Evidenca: Model i Planifikimit të kohës vjetore të punës për personelin akademik në IAL publike për viti akademik 2018–2019. Raporti vjetor i UV-së për vitin 2017-2018, faqe 23. https://univlora.edu.al/2017/12/05/cmimi-ekselence-per-burimet-njerezore-ne-kerkim-per-uv-ne/			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ gjykon se FSHT, ku bën pjesë Departamenti i Matematikës ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme e cila siguron zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe kërkimor. Krahas ambienteve për personelin akademik, atij administrativ, ambiente për bibliotekën e fakultetit ku përveç hapësirave të studimit, janë edhe laboratorët e informatikës, ku studentët mund të punojnë edhe për kryerjen e detyrave të kursit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të merren masa dhe të hartohen strategji për rritjen e numrit të studentëve, pasi për kapacitetet infrastrukturore dhe njerëzore numri aktual i studentëve është shumë i vogël.</i></p> <p>Evidenca: Relacion mbi Bibliotekën shkencore Godina A dhe C, në funksion të akreditimit të programeve të studimit. Përcjellje për infrastrukturën e UV-së.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjykon se ambientët janë të pajisura me salla leksionesh, seminaresh dhe ambiente laboratorësh me kompjutera dhe pajisje në funksion të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Godina C, ku zhvillon aktivitetin mësimor Departamenti i Matematikës ka një sipërfaqe prej 3800 m². Biblioteka e godinës C ka një sipërfaqe prej 80 m² me kapacitet 25 vende studimi, i përshtatshëm për studentët e programit të studimit Bachelor Matematikë.</p> <p>Evidenca: Relacion mbi Bibliotekën shkencore Godina A dhe C, në funksion të akreditimit të programeve të studimit. Përcjellje për infrastrukturën e Universiteti i Vlorës.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ vë re se plotësohen dhe tejkalohen standartet infrastrukturore të përcaktuara në Vendimit Nr 418, datë 10.05.2017. Referuar standartit për shkencat natyrore raporti duhet të jetë 2.5 m²/student, e raportuar për numrin total të studentëve në të dy ciklet e studimit ai është 2.9 m²/student për FSHT.</p> <p>Nga vizita online e kryer në ambientët e FSHT dhe në veçnati të Departamentit të Matematikës, u vu re se laboratorët ishin të pajisur me kompjutera, projektor dhe linjë interneti. Kompjuterat kishin të gjithë të instaluar softet e nevojshme për zhvillimin e lëndëve informatike dhe atyre matematikore.</p> <p>Evidenca: Përcjellje për infrastrukturën e Universiteti i Vlorës/ FSHT/ Departamenti i Matematikës.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ evidentoi se në funksion të studentëve të programit të studimit Bachelor Matematikë janë në dispozicion 4 laboratorë të cilët kanë si destinacion zhvillimin e orëve të laboratoreve për lëndën e fizikës, informatikës dhe statistikës. Kompjuterat e laboratorit të informatikës kanë të instaluar programet SPSS, MINITAB, MATLAB.</p> <p>Evidenca:</p>

	Përcjellje për infrastrukturën e Universiteti i Vlorës/ FSHT/ Departamenti i Matematikës.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Natyra e programit të studimit Bachelor në Matematikë nuk përmban në elementët e planit mësimor realizimin e praktikave profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Referuar dokumentacionit dhe vizitës online në ambientet e bibliotekës, GVJ gjykon se FSHT disponon biblioteka mësimore me hapësira dhe kapacitete të mjaftueshme dhe është e hapur në orare të përshtatshme dhe paralel me oraret e mësimin. Konkretisht UV zotëron bibliotekën qëndrore e cila gjendet në godinat A; B dhe C. Specifikisht për studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Matematikë përdorin bibliotekën e godinës C me sipërfaqe 80 m². Biblioteka C është e hapur prej ditës së hënë deri të premten, prej orës 08.00 deri në 16:00.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/biblioteka/</p>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<p>Nga dokumnetacioni (<i>Relacion mbi Bibliotekën shkencore Godina A dhe C, në funksion të akreditimit të programeve të studimit, fq 5 dhe fq 7.</i>) si dhe kostatimi në vizitën online GVJ arrin në përfundimin se literatura e ofruar nga institucioni përmban shumë tituj dhe me natyrë multidisiplinare. Biblioteka e godinës C përmban tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhë shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore të nevojshme.</p> <p><i>GVJ konstatoi se në këtë bibliotekë mungojnë revista shkencore periodike mbi fushën e shkencave kompjuterike dhe periodikë të matematikës.</i></p> <p>Evidenca: Relacion mbi Bibliotekën shkencore Godina A dhe C, në funksion të akreditimit të programeve të studimit.</p>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	<p>E mbështetur nga MASR, IAL ka vënë në përdorim të stafit akademik dhe studentëve shërbimin e bibliotekës on-line përmes rrjetit akademik shqiptar (RASH) https://univlora.edu.al/biblioteka/ dhe https://ulibrary.rash.al/. Studentët mund të shfrytëzojnë edhe informacionin nga katalogu online i bibliotekës http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss; EIFL/ Informacioni Elektronik</p>

	për Biblioteka www.eifl.net dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë/koordinator për projektin ERA 2012 www.akad.edu.al/era ku studentët dhe pedagogët kishin akses në informacion me tekst të plotë nga ebrary Academic Complete, EBSCO Academic Search Premier, Emerald Management e Journal Collection, MultiScience Journals Collection, ProQuest Central, Taylor & Francis library dhe shumë më tepër.			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Nga verifikimi rezulton se bibliotekat që ndodhet në ambientet e godinës C ka 4 kompjutera dhe 1 projektor, por nuk është e pajisur me programe kompjuterike specifike. Evidenca: Relacion mbi Bibliotekën shkencore Godina A dhe C, në funksion të akreditimit të programeve të studimit.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	GVJ konstaton se gjatë viteve akademike 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020 në kuadër të plan-buxheteve vjetore përkatëse Departamenti i Matematikës ka planifikuar dhe realizuar pasurimin me libra në fondin e bibliotekës, tregues ky i përpjekjeve për të rritur cilësinë e procesit mësimor dhe të jetës studentore.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Referuar dokumentacionit dhe takimit online, biblioteka në godinën A është e hapur në të hapura në orarin 08:00-20:00, ndërsa bibliotekat B dhe C janë të hapura në orarin 08:00-16:00 (e hënë-e premte). Oraret janë të përshtatshme me oraret e mësimit dhe vihen në dispozicion të studentëve. Personeli i punësuar pranë bibliotekës është person me eksperiencë dhe me shumë kompetencë. Evidenca: Relacion mbi Bibliotekën shkencore Godina A dhe C, në funksion të akreditimit të programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Notë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në bazë të dokumentacionit (Manual i përdorimit të sistemit UVMS, https://uvms.univlora.edu.al/user/login) të vënë në dispozicion si dhe nga bieda në takimin online, GVJ konstaton se IAL ka vënë në funksionim të plotë sekretarinë mësimore e cila zotëron në formë të shkruar, regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin me të dhënat akademike, regjistrin e lëshimit të diplomave. E gjithë procedura është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe nenet përkatëse të sanksionuara në Statutin e IAL.

	<p>Sekretaria mësimore arkivon gjithashtu, dosjet e regjistrimit të studentëve, procesverbalet e notave, dosjet e diplomimit. Në funksion të menaxhimit të informacionit UV zotëron sistemin elektronik të komunikimit të brendshëm.</p> <p>Evidenca: Manual i përdorimit të sistemit UVMS https://uvms.univlora.edu.al/user/login</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë takimeve “online” me Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore vuri në dispozicion të GVJ dy dosje, personel akademik të brendshëm dhe personel akademik të ftuar të Departamentit Kimi të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore (UV). Dosjet personale të personelit akademik dhe ndihmës-akademik ishin të plota dhe përmbanin CV, kontratat e punës, diplomat e noterizuara etj. Kjo drejtori administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik si dhe personelit administrativ.</p> <p>Evidenca: Manual i përdorimit të sistemit UVMS https://uvms.univlora.edu.al/user/login</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se UV/Departamenti i Matematikës ka infrastrukturën e nevojshme e cila siguron një sistem menaxhimi të dedikuar dhe konfidencial për personelin akademik, ndihmës-akademik, personelin administrativ dhe studentët. Informacionet personale administrohen në përputhje me Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit realizohet nëpërmjet zyrës së Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore.</p> <p>Evidenca: Rregullore e Universitetit të Vlorës e ndryshuar, neni 89.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik komunikon në mënyrë të rregullt me studentët nëpërmjet platformës e-learning e integruar në sistemin e menaxhimit të informacionit UMS. Nëpërmjet kësaj platforme personeli akademik ju ofron studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me aktivitetin mësimor. Studentët e aksesojnë informacionin nëpërmjet llogarive të tyre. Në të njëjtën mënyrë sigurohen edhe informacionet nga sekretaria mësimore dhe administrata.</p> <p>Evidenca: https://uvms.univlora.edu.al/media/MANUAL_PERDORIMI_UVMS.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe faqes zyrtare të UV, brenda sistemit të menaxhimit UMS është instaluar një llogari e cila mundëson raportimin e të gjithë aktivitetit akademik semestral dhe vjetor të FSHT. Të gjitha problematikat adresohen në këtë llogari. Dekanati realizon përgjigjen e problematikave nëpërmjet rubrikës “Shërbime”.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të</p>	<p>Referuar faqes zyrtare të internetit të UV (https://univlora.edu.al/), Departamenti i Matematikës ka vënë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit Bachelor në Matematikë. Informacioni dhe aktivitetet lidhur me programin</p>

<p>paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>përditësohen rregullisht. Informacionet në faqen zyrtare janë vetëm në shqip.</p> <p><i>GVJ sugjeron, se në kuadrin e ndërkombëtarizimit dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies faqja zyrtare e internetit të UV duhet të mundësohet edhe në gjuhën angleze.</i></p> <p>Evidenca: https://www.uv.edu.al https://u-trasparenca.al/</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	


<p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Sipas gjetjeve në dokumentacion tarifat e shkollimit miratohen çdo vit nga IAL për çdo cikël studimi. Këto tarifa nuk e kapërcejnë tavanin e vendosur nga VKM Nr. 638 dt. 22.07.2015 e ndryshuar. Në kuadër të raportit vjetor, IAL harton periodikisht edhe raportin financiar për mbarëvajtjen e programit për ciklin e plotë të studimit.</p> <p>Evidenca: Raporti vjetor i UV-së 2018-2019.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Referuar dokumentacionit (<i>Raporti vjetor i UV-së 2018-2019, fq. 152-163, Projekt-buxheti në departament</i>), FSHT dhe Departamenti i Matematikë së njësi bazë e tij harton çdo vit plan-buxhetin e cili përfshin pagesat e personelit akademik, personelin akademik të jashtëm ose të ftuar, personelin ndihmës-akademik, personelin administrativ, investimet për laboratorët mesimorë dhe kërkimorë, shpenzime për pasurimin e fondit të bibliotekës, kërkesat për pajisjen me kompjutera dhe videoprojektorë. Në mbështetje të rritjes profesionale të personelit akademik i departamentit planifikon në projekt-buxhet mbështetje financiare për konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>GVJ shpreh mendimin se departamenti duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar grante të huaja në formën e projekteve të cilat mundësojnë pasurimin e laboratorëve didaktikë dhe kërkimorë, pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturë të huaj dhe vënien e tyre në funksion të plotë të realizimit dhe përmisimit të programit të studimit.</i></p> <p>Evidenca: Raporti vjetor i UV-së 2018-2019.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit</p>	<p>GVJ konstaton se auditimet e UV nga Ministrisa e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit janë periodike. UV kryen në mënyrë</p>

<p>dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>të përvitshme auditin e brendshëm, i cili realizohet nëpërmjet Sektorit të Auditit të Brendshëm (referuar organigramës të UV). Raportet financiare përmbajnë informacione të detajuara lidhur me të ardhurat dhe tarifat e shkollimit dhe janë të çertifikuara edhe nga Dega e Thesarit Vlorë.</p> <p>Evidenca: Raporti vjetor i UV-së 2018-2019. www.univloria.edu.al; www.panel.u-trasparenca.al</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>GVJ vëren se UV dhe Departamenti i Matematikës si njësi bazë e tij hartojnë në mënyrë periodike plan-buxhete 3 (tre) vjeçare i cili përmban analiza financiare të hollësishme duke përfshirë të gjithë zërat e nevojshëm për realizimin e programit të studimit. Përveç plan-buxheteve 3 (tre) vjeçare UV/Departamenti i Matematikës realizon edhe analizat financiare vjetore dhe identifikon/planifikon ndërhyrjet e nevojshme për ecurinë normale të programit (<i>Raporti Vjetor i UV-së për vitin 2017-2018, Raporti Vjetor i UV-së për vitin 2018-2019, fq. 176, fq. 222</i>).</p> <p>Evidenca: Raporti Vjetor i UV-së për vitin 2017-2018. Raporti Vjetor i UV-së për vitin 2018-2019.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstaton se UV/Departamenti i Matematikës si IAL publike siguron mbështetjen financiare kryesisht nëpërmjet grantit të përcjellë nga Ministria e Arsimit, Rinisë Sportit. Të ardhurat totale përgjatë viteve akademike 2016-2017--2019-2020, përfshirë të ardhurat nga pushteti qendror/vendor dhe tarifat e shkollimit rezultojnë në rritje, përkatësisht 483,697,327 (2016-2017) dhe 528,575,140 (2019-2020). Kjo dëshmon se IAL ka qëndrueshmëri financiare.</p> <p><i>Departamenti i Matematikës në veçanti ka një numër të vogël studentësh i cili kufizon kapacitetet financiare të departamentit. GVJ sugjeron se departamenti duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të rritur numrin e studentëve në programin e studimit dhe duhet të shfrytëzojë të gjitha burimet e mundshme financiare psh. përfitime financiare nga projektet ndërkombëtare, etj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, FSHT/Departamenti i Matematikës ka hartuar dhe zbaton të gjitha procedurat e nevojshme për një ecuri normale dhe të plotë të ciklit akademik. Procedurat dhe rregulloret janë hartuar dhe bazuar në ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe Aktet nënligjore të tij si dhe kriterëve të parashikuar në Nenin 39 të Rregullores së UV si dhe në kriteret dhe kuotat e propozuara nga Departamenti i Matematikës dhe të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Vlorës. Kriteret dhe kuotat janë të afishuara në faqen zyrtare të UV.</p> <p>Evidenca: Rregullore e FSHT-së.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga lista e dokumentacionit të diponuar rezulton se Departamenti i Matematikës zbaton politikat dhe procedura të barabarta për të gjithë studentët. Studentët informohen rregullisht nga Këshilltari Akademik. adresën elektronike personale në formatin emër.mbiemër@univlora.edu.al që është një ndër formatet e komunikimit midis tij dhe UV (stafit akademik dhe sekretarisë mësimore). Kjo bëhet e mundur përmes sistemit informativ UVMS me anë të së cilës mund të ankimojnë për rezultatin e provimit. Gjithashtu, studentëve u jepet vazhdimisht mundësia për të ndjekur programe të mobiliteteve.</p> <p>Evidenca: Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës. Kuotat e pranimit të studentve në programin e ciklit të parë Matematikë.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në takimet “on-line” që u krye me studentët e programit të studimit Bachelor Matematikë, theksojmë se studentët kontaktin e parë për informacionet lidhur me programin e studimit, regjistrimin, transferimin e studentëve, diplomimin etj. e marrin nëpërmjet faqes zyrtare të UV. Informacione më të detajuara rezultojnë të sigurohen nga afishimet në sekretarinë mësimore si dhe nga kontaktet e drejtpërdrejta me pedagogët, të cilët i mbështesin dhe mundësojnë zgjidhjen e problematikave, nxitur ky lloj komunikimi nga numri i vogël i studentëve.</p> <p>Evidenca: Rregullore e UV-së, https://univlora.edu.al/rregullorja/. Statuti i UV-së, https://univlora.edu.al/statuti/ Faqe zyrtare e UV-së/Këndi “Njoftime”, https://univlora.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e</p>	<p>Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve vijnë në përgjigje të kërkesës së MASR dy vite akademike përpara regjistrimeve në vitin aktual dhe</p>



<p>kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>departamenti propozon kuotat një vit përpara fillimit të vitit akademik për të gjitha kategoritë e studentëve. Pranimet bëhet bazuar në udhëzimet përkatëse të MASR për vitin akademik aktual.</p> <p>Evidenca: Vendim Senati Akademik nr.19 datë 19.04.2018. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/veridim-nr-19.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Nga dokumentacioni që grupi disponoi vihet re se hartimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike të Programit të Studimit Bachelor në Matematikë janë në përputhje me Ligjin nr.80/2015468, VKM-në përkatëse (kriteri i notës mesatare për pranimin e kandidatëve) dhe maturën shtetërore. Sipas RVB në kuotat e pranimit përfshihen jo vetëm kandidatë brenda vendit, nga trojet, shtetas të huaj si dhe kandidatë me statusin e personit me aftësi të kufizuara, kandidatët romë dhe ballkano-egjiptianë si dhe kandidatë që vijnë me transferrim studimesh apo që ndjekin një program të dytë studimi (nga ky grup nuk ka asnjë student të regjistruar në Bachelor Matematikë).</p> <p>Evidenca: Vendim i Senatit Akademik UV, Nr. 8, datë 07.02.2019, “Për miratimin e kuotave të studimit për vitin akademik 2019-2020”. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/vendim-nr-8.pdf Vendim Senati Akademik nr.19 datë 19.04.2018. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/vendim-nr-19.pdf</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UV/FSHT referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga departamenti, dëshmon se çdo fillim viti akademik organizon ditët e hapura “Open Day” për gjimnazistët dhe prindërit e interesuar. Në këto takime marrin pjesë edhe pedagogë dhe studentë nga degë të ndryshme. Në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Edukimit këto takime zhvillohen edhe në qytetet të tjera si Fier, Berat, Lushnje dhe Sarandë.</p> <p>Evidenca: Informacion për aktivitetet e zhvilluara për informimin e maturantëve. Open day.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe takimit me studentët si dhe informacionin e publikuar në ëbsite-in https://univlora.edu.al/departamenti-i-matematikes/ rezulton se institucioni nëpërmjet sistemit elektronik UVMS vë në dispozicion të studentëve të</p>

<p>studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret dhe procedurat akademike. Këtu përfshihen planet mësimore të viteve të fundit, numri i krediteve i nevojshëm për të kaluar nga njëri vit akademik në tjetrin, programet e lëndëve të përditësuara etj.</p> <p>Evidenca: Kalendari Akademik, Vendim i Rektorit, Nr. 1279/1, datë 11.10.2019 https://uni.vlora.edu.al/departamenti-i-matematikes/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vëren se në përputhje me Rregulloren e Departamentit dhe Statutin e Universiteti i Vlorës, departamenti ngre komisione të ekuivalentimit të lëndëve për të realizuar të gjitha procedurat e nevojshme të transferimit të studimeve për studentët që kanë kualifikime nga studimet e mëparshme.</p> <p>Evidenca: Rregullore e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë. Statuti UV-së, Neni 69. Rregullore e UV-së, Neni 56, 57, 58, 59.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e Departamentit të Matematikës përcakton qartësisht procedurat dhe kriteret për vlerësimin e dijeve të studentëve në lëndë të ndryshme të programit të studimit, ku përfshihen mënyra i vlerësimit, kontrolli i dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimi i tyre e deri tek ankimimet. Nga ana tjetër çdo pedagog pasqyron në ëbsite-in e tij kopje të syllabusit ku studenti mund të informohet rreth formës dhe mënyrës së vlerësimit për të gjitha lëndët.</p> <p>Evidenca: Rregullore e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë. Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabus-et e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UV, të departamentit dhe Rregulloren e programit të studimit rezulton se studentët informohen në lidhje me kriteret dhe procedurat e diplomimit. Gjetje të tilla u konstantuan edhe gjatë takimeve “on-line” me studentët. Studentët kanë kontakte të rregullta me këshilltarin akademik dhe me sekretarinë mësimore nëpërmjet të cilëve marrin informacion edhe për punimin e diplomës.</p> <p>Evidenca: Rregullore e UV-së, Neni 65. Rregullore e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë, Neni 3, 14, 15. Rregullore e Diplomimit të FSHT-së. Procedurë diplomimi në Departamentin e Matematikës.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion dhe takimeve me studentët, grupi i vlerësimit të jashtëm konstanton se në periudhën Mars-Maj, UV/Departamenti i Matematikës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore dhe strukturat e brendshme të IAL (Sektori i Këshillimit dhe Karrierës dhe Alumni-t) organizon ditët të hapura për publikun, Ëelcome Day, panairë pune. Në këto</p>

	takime shpërnahen broshura me informacione të detajuara për çdo program studimi.			
	Evidenca: Aktivitete për informimin e maturantëve. Open day. Panairi i Punës 2019			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>GVJ vëren se strukturat e UV/Departamenti i Matematikës si dhe sekretariatë mësimore, këshilltari akademik, koordinatori për marrëdhëniet me studentët, specialisti për shërbim ndaj studentit vihen në dispozicion të studentëve për t'i informuar ata për programin e studimit, syllabuset, zhvillimin e punëve laboratorike etj. Në funksion të informacionit për studentët është edhe faja zyrtare e UV/DM https://uni.vlora.edu.al/departamenti-i-matematikes/programet-e-studimit-matematike/ Gjetje të tilla u konstatuan edhe gjatë takimeve me studentët.</p> <p>Evidenca: Emërtimi i koordinatorit për marrëdhëniet me studentët. https://uni.vlora.edu.al/sektorit-i-keshillimit-te-studenteve-dhe-alumn-i/</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Referuar, <i>Rregullores të programit Bachelor në Matematikë</i>, rezultoi se Departamenti i Matematikës vë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm për programin që ofron. Në ndihmë të informacionit mbi programin e studimit vjen edhe faja zyrtare e UV/Departamenti i Matematikës si dhe sistemi informativ UVMS. Bashkëbisedimet me studentët gjatë takimeve “on-line” konfirmuan këto gjetje.</p> <p>Evidenca: Leksionet e ngarkuara nga stafi akademik i departamentit.</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<p>Bazuar në dokumentacion si dhe nga bisedat me stafin akademik të departamentit, GVJ gjykon se IAL po punon për mbështetjen institucionale të studentëve për orientimin drejt karrierës dhe tregut të punës dhe ka marrë (IAL) pjesë në Panairin e Punës në Vlorë në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit (Maj 2019) ku studentët mund të njihen me informacione për punësim dhe punëdhënës të ardhshëm të mundshëm.</p> <p><i>Në këtë kuadër GVJ sugjeron se FSHT dhe Departamenti i Matematikës në veçanti duhet të realizojë një studim të tregut të punës, e cila mund të</i></p>

	<p><i>përbëjë një bazë për përcaktimin e kuotave të pranimit për këtë program studimi.</i></p> <p>Evidenca: Seminar “Orientim në tregun e punës 1”</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët e programit të studimit Bachelor Matematikë nëpërmjet faqes zyrtare të UV dhe Departamentit të Matematikës, sistemit të menaxhimit të informacionit UVMS, sekretarisë mësimore si dhe stendave të informacionit marrin informacion të përditësuar dhe të gjerë mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit UVMS Univlora, u jep studentëve mundësinë të kenë akses mbi informacione të ndryshme në lidhje me programin e studimit. Studentët janë të pajisur me kode personale nëpërmjet të cilëve mund të marrin informacion për lëndët e tyre, pikët e provimeve, notat etj.</p> <p>Evidenca: https://uvms.univlora.edu.al</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 si dhe Statutit të IAL (nenet 78, 79) Drejtoria e Edukimit për ciklin e I dhe II, institucioni mban dhe përcjell në institucionet përgjegjëse statistikat në lidhje me aplikimet-pranimet, diplomimet (sipas gjinisë femër/mashkull, fshat-qytet). Kryesisht ky informacion përpunohet nga sekretaria mësimore e FSHT në bashkëpunim me sekretarinë e Departamentit të Matematikës.</p> <p>Evidenca: Raporti vjetor i UV-së për vitin 2017-2018. Raporti vjetor i UV-së për vitin 2018-2019.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga verifikimi, rezulton se Sekretaria mësimore e FSHT dhe Sekretaria e Departamentit të Matematikës ka të gjitha statistika për numrin e studentëve të regjistruar në programet përkatëse, çregjistrimet, ngrirjet e studimeve dhe diplomimet në sesionet përkatëse. Njësia kryesore i përcjell këto informacione çdo vit akademik pranë IAL dhe më tej përcillen në MASR.</p> <p>Evidenca:</p>

	Statuti i UV-së, Neni 58 dhe 69. Rregullore e UV-së, Neni 39,42,43,44,56,57,58,79.			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Në sekretarinë mësimore arkivohen i gjithë informacioni ka ka të bëjë me ecurinë e studentit nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tij në atë program studimi, ose reregjistrimin e tij nëse kërkon ose arrin dyfishin e kohëzgjatjes normale të studimit. Procedurat për secilin rast është e mirëpërcaktur në statutin dhe rregulloren e UV. Evidenca: Statuti i UV-së. Rregullore e UV-së.			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Referuar evidencave në faqen zyrtare të UV dhe takimit me sektorin e IT, u dëshmuar se sistemi i menaxhimit të informacionit UVMS, mundëson përveç të tjerave një platformë dixhitale e cila u ofron studentëve dhe stafit të kenë informacion të plotë dhe transparent të procesit mësimor. Nëpërmjet kësaj platforme sigurohen statistika të plota të numrit të studentëve përgjatë vitit akademik, përfshirë këtu edhe studentët që nuk arrijnë ta përfundojnë vitin akademik. Evidenca: Raporti Vjetor i UV-së 2018-2019.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në dokumentacion, GVJ arrin në konkluzionin se IAL ka hartuar <i>Raportin Vjetor</i> ku janë përfshirë veprimtaritë mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve të studimit. Pjesë e këtij raporti është edhe raporti i Departamentit të Matematikës, i cili përfshin informacion të detajuar mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. <i>Në këtë kontekst, GVJ vëren se gjurmimi i punësimit të studentëve është bërë nga Departamenti i Matematikës, gjithsesi ai duhet të jetë i vazhduar dhe i shoqëruar me masat e duhura për të përmissuar cilësisë e punësimit të studentëve e cila në mënyrë indirekte do të ndokojë në rritjen e pranimeve në programin e studimit Bachelor Matematikë.</i> Evidenca: Raporti Vjetor i UV-së 2017-2018. Raporti Vjetor i UV-së 2018-2019.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e

Nga verifikimet gjykohet se IAL vepron në përputhje me LAL Nr. 80/2015, Neni 98, 99, si dhe Statutin e UV, neni 73, 74 angazhon studentët në organet vendimmarrëse.


<p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Konkretisht, Senati Akademik i UV ka dy anëtarë përfaqësues të studentëve. Studentët janë të angazhuar në Këshillin Studentor, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Shtojca-3-Fakulteti-i-Shkencave-Teknike-dhe-Natyrore.pdf https://univlora.edu.al/2019/05/29/njofitim-per-vetekandidim-te-studenteve-te-uv-se-ne-kzs-komisioni-zgjedhorstudentor-ne-fakultete/ https://univlora.edu.al/2019/06/25/njofitim-22/ https://univlora.edu.al/2019/02/15/njofitim-per-zgjedhjet-per-anetar-te-bordit-te-administrimit/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët kanë përfaqësues në Bordin e Adminisrimit dhe Komisionet e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë për çdo njësi Kryesore dhe në nivel Institucionin.</p> <p>Referuar takimeve “on-line” me studentët, GVJ vëren se studentët kanë gjithashtu, Komisionin Institucional Zgjedhor të Studentëve (KIZS) i cili është ngritur me vetëkandidim të studentëve, nëpërmjet të cilit studentët kanë krijuar këshillat studentore në nivel institucioni dhe njësie kryesore. Përsa më sipër, grupi arrin në konkluzionin se studentët e UV/FSHT/Departamentit të Matematikës janë të përfshirë në struktura të rëndësishme vendimmarrëse të jetës akademike.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/2019/05/29/njofitim-per-vetekandidim-te-studenteve-te-uv-se-ne-kzs-komisioni-zgjedhorstudentor-ne-fakultete/ https://univlora.edu.al/2019/06/25/njofitim-22/ https://univlora.edu.al/2019/02/15/njofitim-per-zgjedhjet-per-anetar-te-bordit-te-administrimit/</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Referuar dokumentacionit (plani mësimor, syllabuset e lëndëve, suplementi i diplomës) të programit të studimit Bachelor Matematikë, i cili është hapur në vitin 2008, vihet re se ai është në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, dhe më konkretisht Udhëzimi Nr. 15, datë 04.04.2008 dhe VKM, Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Evidenca: Plani mësimor Bachelor Matematikë. Syllabuset e programi Bachelor Matematikë. Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Referuar diskutimeve me studentët në takimet “on-line”, rezulton se FSHT/Departamenti i Matematikës ka një komunikim të mirë dhe të vazhdueshëm me studentët dhe se mendimi i tyre dëgjohet në hallkat vendimarrëse. Evidencë për këtë është përfshirja e studentëve në grupin ad-hoc për hartimin e pyetësorit. Konkretisht, Këshilltari ose Koordinatori akademik si dhe Përgjegjësja e Departamentit organizojnë në mënyrë të rregullt takime me studentët.</p> <p>Evidenca: Urdhër Nr. 123 datë 19.12.2019, Urdhër mbi ngritjen e grupit të punës ad-hoc për pilotimin e pyetësorit të shërbimeve mbështetëse.</p>

<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultati, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton, se procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë këtu edhe mundësinë e ankimimit të rezultati nga ana e studentëve është i sanksionuar në githa rregulloret e IAL (<i>Rregulloren e universitetit, departamentit dhe të programit të studimit</i>).</p> <p>Referuar takimeve me studentët, studenti mund të kërkojë ankimim për rezultatin e provimit. Ankimimi i dorëzohet me shkrim Përgjegjësës së Departamentit, e cila vë në dijeni Dekanin. Ky i fundit ngre komisionin <i>ad hoc</i> i cili verifikon pretendimet e studentit/tes.</p> <p>Evidenca: Rregullore e UV-së, Neni 62 dhe 70 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Matematikë, Neni 11.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="603 607 759 674">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="759 607 979 674">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="979 607 1201 674">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1201 607 1406 674">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="603 674 759 716"></td> <td data-bbox="759 674 979 716"></td> <td data-bbox="979 674 1201 716"></td> <td data-bbox="1201 674 1406 716" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Kontaktin fillestar për të siguruar informacionin paraprak studentët e IAL e kanë me faqen zyrtare të UV/Departamenti i Matematikës ku mund të gjejnë edhe llogarinë e facebook-ut të UV/Departamentit. Referuar takimeve me studentët, u konstatua se në shërbim të informimit të studentëve është ngritur sekretaria mësimore e cila kryen të gjitha shërbimet akademike dhe zyra e studentit e cila mundëson shërbimin e bursave.</p> <p>Evidenca: https://uni.vlora.edu.al/administrata/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të informimit dhe këshillimit të studentëve është vënë edhe shërbimi i Këshilltarit ose Koordinatorit akademik. Ky i fundit asiston dhe këshillon intesinsivisht, në veçanti, studentët e vitit të parë. Studentëve të vitit të parë u jepet gjithashtu, mundësia të takohen me studentët viteve të dyta apo të treta për informacione shtesë, orientime etj. Broshurat apo fletëpalosjet informuese të hartuara nga Departamenti i Matematikës janë gjithashtu në shërbim të informimit të studentëve.</p> <p>Evidenca: Emërimi i Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione</p>	<p>Referuar organigramës së IAL, UV ka ngritur në shërbim të këshillimit dhe karrierës të studentëve, Sektorin e Këshillit të Karrierës ALUMNI dhe aktiviteteve kulturore-sportive. Referuar takimeve me studentët ky sektor informon studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike lidhur me kompletimin e procesit mësimor, mundësitë e punësimit, zhvillimin e praktikës etj.</p> <p>Informacionet në lidhje me zyrën e ALUMNI-it gjenden në faqen zyrtare https://uni.vlora.edu.al/alumni/. Në këtë faqe studentët e ALUMN-it</p>



të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	mund të njihen edhe me database-in e tyre si dhe formularin e regjistrimit. GVJ konstaton se kjo zyrë, ndjek në mënyrë të rregullt karrierën profesionale të alumneve të saj nëpërmjet evidencave të mbajtura gjatë aktiviteteve periodike.			
	Evidenca: https://univlora.edu.al/sektorit-i-keshillimit-te-studenteve-dhe-alumn-i/			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gjithashtu, në funksion të mundësive të punësimit, Sektori i Këshillimit të Karrierës ALUMNI ka organizuar “Panairin e punës”, “Open Day” etj. Ky kriter nuk është specifik për studentët e programit të studimit Bachelor Matematikë, pasi ato nuk mund të punësohen me këtë diplomë. <i>Sidoqoftë, GVJ nuk gjeti të dhëna mbi strategjitë e punësimit të studentëve të cilët diplomohen në programin e studimit Bachelor Matematikë.</i>			
	Evidenca: https://univlora.edu.al/sektorit-i-keshillimit-te-studenteve-dhe-alumn-i/			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ gjykon se IAL në zbatim të LAL nr. 80/2015 pika 1, ka ngritur struktura në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Këto struktura IAL, i ka të parashikuara në Statut (Kreu VIII, neni 81- 83), Planin Strategjik 2018-2024 të UV-së, miratuar me vendim Bordi Administrimi Nr. 26 , datë 08.11.2018. Gjithashtu, GVJ konstanton se IAL ka parashikuar në Statutin e vet, ngritjen e Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel Institucioni dhe Njësie Kryesore. Bazuar në evidencat mbështetëse, GVJ konstanton se IAL në Vendimin e Senatit Nr. 21 , datë 08.05.2018, Vendim Senati Nr. 52 , datë 20.04.2017 dhe Vendim Senati Nr. 51 , datë 20.09.2019, ka miratuar pyetësorë për studentët në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e personelit akademik, ndihmës akademik etj. GVJ vlerëson se IAL ka ndërmarë të gjitha hapat për të siguruar strukturat dhe procedurat e nevojshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.

	<p><i>Gjatë takimeve "on-line" u konstatua se studentët marrim pjesë në anketime të ndryshme duke ju përgjigjur formularëve përkatës në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit.</i></p> <p>Evidenca: Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/vendim-nr-21.pdf https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/vendim-nr-29.pdf</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë UV ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBCVI) e cila është vënë në zbatim të strategjisë së IAL dhe përmisimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Njësia ka në përbërjen e saj edhe studentë dhe funksionon në bazë të Rregullores së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>GVJ konstaton gjithashtu se nuk ka evidencë mbështetëse të aktivitetit të NJSBC.</i></p> <p>Evidenca: Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Në funksion të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UV ka realizuar me sukses vlerësimin e jashtëm institucional. Vlerësimi i jashtëm është kryer nga kjo IAL me qëllim vlerësimin e shkallës së përmbushjes së Standarteve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë. Proçesin i Akreditimit të Parë Institucional, IAL e ka përfunduar me një vlerësim pozitiv me një kohëzgjatje prej 3 (tre) vite akademike. Ky vlerësim dëshmon se UV zotëron dhe përdor instrumentet e duhura për përmbushjen e standarteve, sigurimin dhe përmisimin e cilësisë. IAL gjithsesi ka nevojë të përmirësojë shërbimet e ofruara dhe të marrë masat për plotësimin e rekomandimeve të BA.</p> <p>Evidenca: Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Vendim i Senatit Akademik Nr. 29, datë 22.05.2018 "Për Planin e veprimit në kuadër të rekomandimeve nga Bordi i Akreditimit". https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/vendim-nr-29.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësisive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, IAL ka ngritur Njësinë e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë. Gjithashtu, IAL ka parashikuar në Statutin dhe Rregulloren e saj procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. NJSBCVI ka përfunduar hartimin e Draft Rregullores për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe e ka përcjellë pranë Senatit Akademik për miratim. NJSBCVI ka kryer dy pyetësorë për vlerësimin që studentët kanë dhënë për lëndët, përkatësisht në vitet 2017-2018 dhe 2018-2019.</p> <p><i>GVJ sugjeron se nevojitet hartimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ gjykon se në funksion të monitorimit, shqyrtimit dhe rishikimit të programeve të ciklit të parë dhe të dytë, UV ka ngritur Drejtorinë e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë. Këtu përfshihet edhe Sektori i Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentit. Në shërbim të përmisimit të programeve funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBCVI). IAL ka parashikuar edhe ngritjen e Komisioneve të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme (në nivel fakulteti). Dekanati i fakultetit i përbërë nga Dekani, Zv/Dekane, Administratori dhe Përgjegjësat e Departamenteve drejtojnë dhe koordinojnë zhvillimin e procesit mësimor, marrëdhënien me studentët dhe nxisin kërkimin shkencor të stafit akademik.</p> <p>Evidenca: Statuti i UV-së, neni 13, pika 1, shkronja “c”. Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ vëren se UV/ Departamenti i Matematikës përdor skema dhe praktika efikase për kontrollin e programit të studimit që ai ofron. Institucioni ka hartuar raportin vjetor në nivel fakulteti. Departamenti i Matematikës ka tentuar të propozojë ndryshime në programin e studimit Bachelor Matematikë referuar LAL, VKM dhe Udhëzimeve apo Urdhërave përkatëse. Në nivel institucioni është Drejtoria e Edukimit për ciklin e parë dhe të dytë e cila vlerëson propozimet mbi ndryshimet e mundëshme të programit mësimor dhe i përcjell më tej në Senatin Akademik për miratim.</p> <p>Gjithashtu, IAL ka hartuar pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Këta pyetësorë përcillen tek studentët në fund të çdo semestri dhe para sezonit të provimeve; diskutimet e studentëve me pedagogët si dhe gjetjet nga organizimi i Ëorkshop-i me temë “<i>Studentët dhe tregu i punës</i>”.</p> <p>Evidenca: Raporti vjetor i UV-së për vitin 2018-2019 Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Në kuadër të hartimit të raportit vjetor në nivel institucional, GVJ vëren se, Departamenti i Matematikës ka hartuar analizën vjetore e cila përmban informacione të detajuara në lidhje me numrin e përvitshëm të studentëve frekuentues, funksionimin e Këshillimit akademik, numrin e të diplomuarve, kalueshmërinë e studentëve, pyetësorët, ankesat e protokolluara të studentëve etj. Raporti/analiza vihet në funksion të vlerësimit dhe mbarëvajtjes së programeve të studimeve.</p> <p>Në dy vite të njëpasnjëshme akademike është zhvillua anketimi i studentëve me qëllim vlerësimin e cilësisë së programit Bachelor Matematikë si dhe matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira. Metodologjia e studimit ka qenë sasiore dhe instrumenti i përdorur është</p>

	<p>pyetësoni i miratuar me Vendim të Senatit Akademik. Pyetësoni përmban është pyetje të hapura, për të marrë opinionet e studentëve për secilin pedagog.</p> <p>Evidenca: Raport mbi rezultatet e pyetësonit studentor për vitin akademik 2017-2018. Vendim Senati nr. 51 datë 20.09.2019. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/10/vendim-nr-51.pdf Vendim Senati nr. 52 datë 20.04.2017. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2017/12/Vendim-Senati-Nr.52-date-20.04.2017.pdf Plani i masave FSHT që ka dalë nga pyetësoni.</p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Referuar raportit të publikuar në faqen zyrtare, rezulton se UV/FSHT dhe Departamenti i Matematikës kanë vënë në zbatim Procedurën e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi. Në këtë kontekst, NJSBCVI ka përpiluar Raportin e Analizës, propozimet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e cilësisë të programeve dhe mësimdhënies. <i>Në vijim të vlerësimit tonë (Standardi VI.1, kriteri I) ku pasqyrohet raporti mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019 dhe analizën e rezultateve të pyetësorit (diskutohet në Mbledhje Departamenti), GVJ konstanton se plani i masave për rezultatet e pyetësorëve të vitit akademik 2018-2019. Drejtpërdrejt autoriteti përgjegjës për programin e studimit është departamenti dhe nga ky i fundit kemi konfirmimin që diskutohen në mbledhje.</i></p> <p>Evidenca: Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/RAPORT-PYETESORI-Hyrje.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet e vlerësimit janë kryer në dy vitet akademike dhe një plan masash vihet re të jetë marrë vetëm për vitin akademik 2017-2018 pasi për vitin akademik 2018-2019 është ende në proces.</p> <p>Evidenca: Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018. https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2019/12/RAPORT-PYETESORI-Hyrje.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve


Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njëria e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se programi i studimit Bachelor Matematikë ka hartuar dhe dorëzuar RVB, ndërkohë që Departamenti i Matematikës ka kryer në dy vite akademike Raporte të punës vjetore 2017-2018, 2018-2019, ku është e dokumentuar aktiviteti mësimor (ngarkesa mësimore, shpërndarja sipas grup-lëndëvë) dhe kërkimor i departamentit (botime, referime, trajnime të zhvilluara në kuadër të promovimit të stafit akademik si dhe të fromimit të vazhduar të tij).</p> <p>Evidenca: Raporti Vjetor i UV-së 2017-2018. Raporti Vjetor i UV-së 2018-2019. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/RAPORT-PYETESORI-Hyrje.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Referuar natyrës dhe specifikës së kërkimit (vlerësimi i cilësisë së programeve akademike), për kryerjen e vlerësimit, IAL/UV, ka përdorur metodën sasiore duke analizuar gjetjet e prodhuara nga pyetësi, por nuk ka një analizë të mëtejshme për të shpjeguar nëse ka një korrelacion midis perceptimit të studentit me atë të pedagogut. Në 2 vitet e fundit IAL/UV ka hartuar raporte që evidentojnë aktivitetin mësimor dhe kërkimor të stafit akademik referuar Udhëzimit Nr.5, datë 19.02.2018 “Për Përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe Afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”.</p> <p><i>Nga RVB nuk vihet re një metodë apo skemë vlerësimi specifike për programin e studimit Bachelor Matematikë, pasi ajo sasiore e përmendur është shumë e përgjithshme do të sugjerohej një vlerësim cilësor dhe analizë për evidentimin e faktorëve që luajnë një rol kyç në programin në fjalë.</i></p> <p>Evidenca: Raporti Vjetor i UV-së 2017-2018. Raporti Vjetor i UV-së 2018-2019.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Referuar takimit me stafin akademik të Departamentit të Matematikës, Drejtuesja e Departamentit në bashkëpunim me anëtarët kontrollon dhe vlerëson përmbajtjen e kurrikulave, syllabuseve etj. Në këtë të fundit pasqyrohen edhe rekomandimet e vitit të mëparshëm akademik për përmirësim të mëtejshëm të tij. Drejtuesja e Departamentit realizon vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së leksioneve/seminareve etj. Pyetësorët e studentëve e vërtetojnë një veprimtari të tillë.</p> <p><i>GVJ nuk gjen evidenca të dokumentuara për një raport të vlerësimit të lëndës nga pedagogu në korrelacion me atë të vlerësimit nga studenti.</i></p> <p>Evidenca: Analiza e rezultateve të anketimit të studentëve mbi stafin akademik të Departamenti i Matematikës. https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, rezulton se IAL/UV krahas pyetësorëve me studentët të cituara më herët, përdor edhe metoda e instrumente të tjera të tërthorta vlerësimi, si për shembull statistikat mbi</p>

<p>metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>punësimin e studentëve, takimet me bashkëpunëtorë, ekspertë të jashtëm dhe sektorin e kurrikulave, ëorkshop-in “Studentët dhe tregu i punës”, ku merret dhe vlerësohet mendimi i grupeve alumni.</p> <p>Referenca: https://univlora.edu.al/alumni/ v https://univlora.edu.al/2019/12/22/ëorkshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes/</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Referuar takimit me përfaqësues të fakuletit dhe universitetit GVJ vuri re që IAL/Departamenti i Matematikës bashkëpunon me të gjithë hallkat drejtuese dhe stafin administrative në përmbushje të detyrave të përcaktura në statutin dhe Rregulloren e UV. Është në pritje për miratin nga Senati Akademik edhe Rregullorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Efidencë për përfshirjen e faktorëve të jashtëm është ëorkshopit i organizuar në Dhjetor 2019 si dhe nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione/biznese publike e private.</p> <p>Evidenca: Vendim Senati Nr. 21, datë 08.05.2018 “Për procedurën e analizës dhe vlerësimin të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/vendim-nr-21.pdf Plani i masave FSHT që ka dalë nga pyetësori.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p><i>Për përmbushjen e këtij kriteri nuk ka evidence të qarta dhe të matshme, por palët nga takimi i zhvilluar garantojnë që me miratimin e Rregullores së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë do të hartojnë një plan punë të qartë dhe me detyra specifike.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p><i>Bazuar në konstatimet e drejtpërdrejta plotësimi i këtij kriteri nuk garantohet pasi ende nuk janë ngritur në nivel fakulteti Komisionet e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, veprimtari e cila deri me tani është mbuluar nga Zv/Dekani.</i></p>




<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në bisedat me përfaqësues të NJBSC dhe studentë rezultojnë se është krijuar një mekanizëm ciklik për vlerësimin e procesit të mësimdhënies pa cënuar të drejtat dhe integritetin e stafit akademik dhe studentëve, dhe mbi të gjitha kduke ruatur anonimitin e këtij të fundit, sipas Ligjit Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p> <p>Evidenca: Vendim Senati Nr. 21, datë 08.05.2018 “Për procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/vendim-nr-21.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Nga takimet “online” GVJ arriti në përfundimin se garantohej përfshirja e ekspertëve të jashtëm në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, këto kryesisht nga grupet alumni, raste suksesi. Departamenti ka kontakt të vazhdueshëm me institucione që operojnë në sektorin publik dhe privat të cilët janë punëdhënës potencial të studentëve të këtij programi. Në nivel institucional, departamenti, ka marrëveshje bashkëpunimi për praktikantë mësimorë me këta aktorë.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/2019/12/22/workshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes/</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Efidencë për përmbushjen e këtij kriteri janë postimet dhe publikimet në faqen zyrtare të universitetit programeve të lëndëve, raporteve të ndryshme, vendimeve të senatit etj.</p> <p>Evidenca: https://u-trasparenca.al/ https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nga të dhënat e publikuara, kryesisht atyre që kanë të bëjnë me vlerësimin në nivel kurrikule, vihet re respektimi i lirisë dhe etikës akademike dhe Ligjit Nr. Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/</p>



<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga evidentimet janë kryer dy vlerësime nga NJSBCVI dhe përkatësisht për vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, por bazuar në dokumentacionin përkatës disponohet vetem një plan masash të miratuar nga Senati Akademik i UV dhe kontrtësisht për vitin akademik 2017-2019.</p> <p><i>GVJ rekomandohen përpilimin e planit të masave referuar raportit të vlerësimit të kryer për vitin 2018-2019.</i></p> <p>Evidenca: Plani i masave nga rektorati për përmirësimin e cilësisë të programeve të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Një dëshmi e përmbushjes së këtij kriteri është Vendim Senati Nr.17, datë 28.03.2019, në të cilin institucioni merr masa për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së monitorimit të procesit të vlerësimit të procesit mësimor, infrastrukturor dhe didaktik.</p> <p>Evidenca: Vendim Senati Nr.17, datë 28.03.2019. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/05/vendim-nr-17.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion dhe nga takimet e zhvilluara me përfaqësues të NJSBCVI, u gjetën efidencat për Planin Vjetor të Punës, në të cilën janë planifikuar dhe realizuar në mënyrë të përvitshme aktivitete dhe seminare informuese në trajtën e javëve sensibilizuese për përfshirjen e aktorëve të brendshëm në vlerësimin e programeve të studimit, cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës akademik dhe administrativ, më specifikisht në muajt Shkurt, Mars, Maj, Qershor dhe Tetor.</p> <p>Evidenca: https://univlora.edu.al/aktivitete/</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	--	------------------------------

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Matematikë” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë”

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Stafit akademik ka përgatitjen shkencore dhe didaktike në nivele të larta.
2. Ambientet fizike, materialet didaktike, laboratorët janë një aset i këtij departamenti.
3. Nga biseda me studentët u vu re se falë komunikimit mes stafit pedagogjik dhe studentëve, nuk është ndier mangësi në cilësinë e mësimdhënies gjatë zhvillimit të mësimin në distancë të periudhës së pandemisë.

Pika të dobta:

1. Numri i ulët i pranimeve të studentëve të rinj nga viti në vit.
2. Mungon një vlerësim i mirëfilltë i shprehur me vlera sasore për tregun e punës dhe strategjinë e punësimit për studentët të cilët diplomohen në Bachelor Matematikë.
3. Mungon përfshirja e studentëve në projekte kërkimore.
4. Numri i vogël i orëve të laboratoreve.

Rekomandime:

1. Rekomandohet hartimi dhe zbatimi i një plani masash të menjëhershme me qëllim rritjen e interesit të studentëve që të vijnë pranë Departamentit të matematikës. GVJ është i vetëdijshëm që rritja në mënyrë progresive në programet e studimit të cilat të çojnë në drejtimet e mësuesisë është një arsye e fortë e numrit të gjithnjë e në ulje të pranimeve në programin Bachelor Matematikë, por sugjeron që IAL të mbështesë më fuqimisht Departamentin e Matematikës për zhvillimin e një fushate marketingu me qëllim që të nxiten maturantët e qyteteve përreth Vlorës, për të kryer studimet e tyre në programin Bachelor Matematikë.
2. Përveç përpjekjeve institucionale, rekomandohet një trajtim i veçantë në rastin e promovimit të programit të studimit Bachelor Matematikë. Në këtë kuadër GVJ sugjeron se FSHT dhe Departamenti i Matematikës në veçanti duhet të realizojë një studim të tregut të punës, e cila mund të përbëjë një bazë për përcaktimin e kuotave të pranimit për këtë program studimi.
3. Një tjetër sugjerim është referimi i drejtpërdrejtë me sektorin privat dhe publik arsimor, nisur nga gjeografia e afërt e universitetit me vendbanimin si dhe gjurmimi me anë të grupeve Alumni.
4. GVJ evidenton se në disiplinat matematikore zhvillohen vetëm leksione dhe seminare dhe sugjeron që të shtohen edhe orë laboratorike, sidomos në lëndët Probabilitet-Statistikë dhe Analizë Numerike të cilat mundësohen nëpërmjet softëve kompjuterike.
5. Studentët e ciklit të parë në Matematikë kanë qenë të përfshirë në programin “Erasmus +”, por nuk vihet re trend për ardhje studentësh me anë të transferimit të studimeve apo për punësim pas



- përfundimit të studimeve. GVJ sugjeron që studentët të përfshihen përveç "Erasmus+" edhe në projekte kërkimore duke filluar me projekte të vogla të financuara nga IAL.
6. Rekomandohet që njësia të përfshijë një pyetësor më specifik vetëm për studentët e Bachelor Matematikës, ku të vlerësohen përveç aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik edhe mbështetja e stafit ndihmës akademik.
 7. GVJ rekomandon sekretimin dhe kodifikimin e provimeve.
 8. Sugjerohet që në pyetësorët e hartuar të ketë pyetje të cilat marrin gjykimin e studentit në lidhje me rezultatet e kontrollit si dhe një analizë sasiore në lidhje me këtë çështje.
 9. Rekomandohet përfshirja e lëndëve me karakter ekonomik, me qëllim që studentëve t'u jepet mundësi e diversifikimit të studimeve në ciklin e dytë, për faktin që UV ka Fakultetin e Ekonomisë.
 10. Sugjerohet vënia në zbatim të "Udhëzuesi mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë", për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor.
 11. GVJ sugjeron, se në kuadrin e ndërkombëtarizimit dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies faqja zyrtare e internetit të UV duhet të mundësohet edhe në gjuhën angleze.
 12. GVJ shpreh mendimin se departamenti duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar grante të huaja në formën e projekteve të cilat mundësojnë pasurimin e laboratorëve didaktikë dhe kërkimorë, pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturë të huaj dhe vënien e tyre në funksion të plotë të realizimit dhe përmisimit të programit të studimit.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor "Mathematics" of the Institution of Higher Education "Ismail Qemali University", Vlorë "


Strengths and affirmations:

1. Academic staff has scientific and didactic training at high levels.
2. Physical facilities, didactic materials, laboratories are an asset of this department.
3. From the conversation with the students it was noticed that thanks to the communication between the pedagogical staff and the students, there is no lack in the quality of teaching during the development of distance learning during the pandemic period.


Weaknesses:

1. Low number of admissions of new students from year to year.
2. There is a lack of a genuine assessment expressed in quantitative terms for the labor market and the employment strategy for students graduating with a Bachelor of Mathematics.
3. Involvement of students in research projects is lacking.
4. Small number of laboratory hours.

Recommendations:



1. It is recommended to design and implement a plan of immediate measures in order to increase the interest of students to come to the Department of Mathematics. EEG is aware that the progressive increase in study programs that lead to teaching directions is a strong reason for the ever-decreasing admission to the Bachelor Mathematics program, but suggests that HEIs more strongly support the Department of Mathematics for the development of a marketing campaign in order to encourage graduates of cities around Vlora, to conduct their studies in the Bachelor Mathematics program.
2. In addition to institutional efforts, a special treatment is recommended in the case of promoting the Bachelor Mathematics study program. In this context, EEG suggests that FSHT and the Department of Mathematics in particular should conduct a labor market study, which can be a basis for determining the admission quotas for this study program.
3. Another suggestion is the direct reference to the private and public education sector, based on the geography of the university close to the place of residence as well as the tracing of Alumni groups.
4. EEG points out that only lectures and seminars are held in mathematical disciplines and suggests that laboratory hours be added, especially in the subjects Probability-Statistics and Numerical Analysis which are made possible through computer software.
5. Students of the first cycle in Mathematics have been included in the program "Erasmus +", but there is no trend for students to come through transfer of studies or for employment after graduation. EEG suggests that students be involved in addition to "Erasmus +" in research projects starting with small projects funded by HEIs.
6. It is recommended that the unit include a more specific questionnaire only for Bachelor Mathematics students, where in addition to the teaching and innovative skills of the academic staff, the support of the academic support staff is also evaluated.
7. EEG recommends secrecy and codification of exams.
8. It is suggested that in the designed questionnaires there are questions which take the student's judgment regarding the test results as well as a quantitative analysis regarding this issue.
9. It is recommended to include courses of economic character, in order to give students the opportunity to diversify their studies in the second cycle, due to the fact that UV has the Faculty of Economics.
10. It is suggested to implement the "Guide on the development and use of different and innovative teaching methods based on the field of study at the University" Ismail Qemali ", Vlora", for further professional qualification of academic staff and scientific teaching staff .
11. EEG suggests that in the context of internationalization and increasing the quality of teaching and learning, the official UV website should also be available in English.
12. EEG is of the opinion that the department should make continuous efforts to secure foreign grants in the form of projects which enable the enrichment of didactic and research laboratories, the enrichment of the library fund with foreign literature and their full operation of realization and improvement of the study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Niveli përmbushjen	Përmbushjen pjesërisht	Përmbushjen kryesisht	Përmbushjen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

